

Kuvendi i studimeve albanologjike (2021)

Preambol

Në vitin 2022 mbushet një gjysmë shekulli nga koha e mbajtjes së Kuvendit I të Studimeve Ilire (1972), me pjesëmarrjen e personaliteteve më të shquara të albanologjisë dhe në Botë. Kuvendi II i Studimeve Ilire, mbajtur më 1985, në të vërtetë qe një forum shkencor me spektër kërkimor vetëm në arkeologji.

Gjatë një gjysmë shekulli që ka kaluar që nga viti 1972 albanologjia ka shenjuar ndryshime në cilësi dhe në shtrirje. Janë thelluar argumentet bazë për tezat dhe hipotezat që përbëjnë paradigmen e albanologjisë. Rrugën e tyre të njohur kanë ndjekur një pjesë e madhe e antitezave që janë mbrojtur nga individë e shkolla të albanologjisë jashtë hapësirës shqiptare. Interesi për botën shqiptare është rritur veçmas në shekullin XXI, me stabilizimin e perspektivës europiane të Shqipërisë, me pavarësimin e Kosovës dhe me rritjen e rolit politik-qeverisës të shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut dhe në Mal të Zi. Kërkime të reja shkencore në terren dhe në arkiva, të rezervuara më parë, janë inkurajuar nga kushtet e shoqërisë së hapur dhe të teknologjisë së numerizimit të informacionit (korpuset e leksikut të shqipes në Rusi, Gjermani, Itali). Janë zbutur kufijtë midis disiplinave që përbëjnë albanologjinë dhe janë shtuar kërkimet me karakter ndërdisiplinor e transdisiplinor. Ndërveprimi i albanologjisë vendëse me atë të huaj është shumë më intensiv dhe më rezultativ. Albanologjisë tradicionale i janë afruar e shtuar edhe dije që më parë konsideroheshin të fushave teknike (gjenetika, paleontologjia, etnoflora e etnofauna, albanitet në mineralogji etj.). Kanë ndryshuar raportet midis institucioneve dhe peshës që mbajnë studimet albanologjike në Tiranë e Prishtinë, në Shkup e Tetovë, në botën arbëreshe dhe vetë raporti e pësja e tyre bashkërisht kundrejt *albanologjisë së tjetrit*. Disiplinat që përbëjnë albanologjinë, tashmë të konsoliduara në objekt, qëllim e teza, me pavarësinë e tyre relative, kanë ndjekur secila rrugën e tyre, duke rezultuar në këtë proces edhe shpërpjesëtime (zbulimet në arkeologji kanë pasur një ritëm më të shpejtë; kërkimet në prapatokë kanë certifikuar kultura ilirike të pandikuara). Problematikës tradicionale të albanologjisë i janë shtuar çështje të reja (identiteti, etnotipi, raporti fe-etnicitet-gjuhë). *Albanologjisë së jashtme* i janë shtuar disiplina që më herët ose nuk ekzistonin, ose ishin krejt periferike, si studimet letrare, me ndërkombëtarizimin e letërsisë shqipe. Studimet letrare tashmë janë shndërruar në dije universitare europiane dhe botërore. Kanë ndryshuar mjaft raportet *midis albanologjisë si shkencë dhe albanologjisë vullnetare, e cila ka rikthyer romantizmin dhe albanocentrizmin*, duke e rrezikuar dijen e vërtetë

përballë kritikizmit albanologjik të jashtëm. Vërehet një ndryshim sjelljeje prej disa shkollave të albanologjisë në Botë (studimet ruse, në vend të popullsisë sllave në hapësirën shqiptare, po arkivojnë pasurinë leksikore dhe etnogjuhësore të ngulimeve të shqiptarëve në mjedise sllave ose aloglote). Disa qendra të albanologjisë, që deri vonë kishin si qëllim mësimin e shqipes për qëllime praktike (përkthim, diplomaci), janë shndërruar tashmë edhe në qendra të mirëfillta kërkimi albanologjik (Kinë, SHBA). Katedrat e albanologjisë dhe studimi i shqipes në Botë më së shumti janë forcuar e ringritur dhe vlerësohen në proces fuqizimi (Itali, Bullgari, Kinë, Rusi, SHBA, Gjermani), por në disa raste dhe janë rrudhur (Poloni, Francë). Herë pas here, për shkaqe joshkencore, janë atakuar edhe tezat themelore të albanologjisë themeluar nga shkolla austro-gjermane, si burimi etnogjenetik (teza e burimit prej besëve); vlerat e qytetërimit iliro-shqiptar (botimet enciklopedike në disa vende të Ballkanit); historia e trojeve shqiptare (Serbi); shkalla e iliricitetit tek shqiptarët dhe tek disa popuj fqinjë, ndikimet dhe adstratet në kulturën e lashtë (romanitas, dukuritë e kulturës helene); roli i shqiptarëve në perandoritë e mëdha (Bizanti, Perandoria Otomane); lëvizjet migratore të shqiptarëve etj. Një përmasë të re kanë fituar studimet albanologjike prej përfshirjes në studimet indoeuropeistike (E. Hamp), në shkollat e reja gjuhësore, në shqyrtime funksionale teorike etj. Çështje e mprehtë është ajo e pikëpyetjeve për karakterin (*centum* apo *satem*) të ilirishtes, që ndërlikon tërthorazi vazhdimësinë gjenetike dhe tipologjike të shqipes si gjuhë *satem* me certifikim përfundimtar.

Gjatë një gjysmë shekulli janë mbajtur konferenca ndërkombëtare shumë të rëndësishme në fusha të ndryshme të albanologjisë, sidomos në arkeologji, në historiografi (600-vjetori i lindjes dhe 550-vjetori i vdekjes së Gjergj Kastriotit), në gjuhësi dhe histori shkrimesh, në çështje të epikës heroike legjendare, në vendin e letërsisë shqipe në letërsinë europiane (Itali, Shqipëri). Konferenca albanologjike që kanë bashkuar shkolla të ndryshme të studimeve shqiptare janë mbajtur gjatë kësaj periudhe në shumë vende europiane dhe joeuropiane (Itali, Gjermani, Poloni, Kroaci, Austri, Kinë, Maqedoni e Veriut).

Një traditë studimesh më vete ka krijuar edicioni i konferencave të organizuara nga ASHAK për arritjet, gjendjen dhe perspektivat e kërkimit në shkolla europiane e amerikane të albanologjisë (albanologjia në arealin e gjermanishtes, në SHBA, në Itali etj.). Në këto konferenca janë bashkuar studiues të disa disiplinave të albanologjisë, por jo me një platformë që synon sinergji, koordinim, rezultate që mbështesin ndërsjelltas me argumente tezat bazë të albanologjisë (burimi etnogjenetik i popullit shqiptar, karakteri vendës i tij, vazhdimësia në këto troje, restriksioni i tyre në rrjedhë të shekujve, homogjeniteti etnik i shqiptarëve etj.).

Ndikim fragmentarizues ka pasur edhe riorganizimi shtetëror i institucioneve shkencore në Shqipëri e Kosovë, jo rrallë nxitur prej vullnetesh të pastuduara politike. Projektet me karakter institucional janë dobësuar krahasimisht me

punën individuale të kërkuesve. Për disa dije statusi epistemologjik ka pësuar ndryshime dhe ende nuk ka një marrëveshje termonologjike për objektin dhe funksionet e tyre (antropologjia fizike dhe ajo kulturore, filologjia e tekstit dhe filologjia si shumatore shkencash, deri edhe vetë albanologjia si koncept). Studimet sociologjike po zënë vendin e atyre etnologjike, etnografike dhe antropologjike. Kërkimet në terren janë zëvendësuar me kërkimet në arkivat e trashëguara. Miti i metodës si garante e suksesit ka dobësuar thellimin në fakte dhe argumente. Përparësia ndaj monitorimeve dhe vrojtimeve simpliste me qëllime pragmatike, shpesh të inkurajuara prej programesh europiane, ka bërë që studimet shqiptare të mos kenë më helenistë, romanistë, sllavistë, osmanistë, ekspertë që janë me shumë rëndësi në këto studime.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, së bashku me institutet dhe universitetet, kanë përgjegjësinë e njohjes së gjendjes së albanologjisë në vendet e tyre dhe në Botë, për mbajtjen e lidhjeve dhe ballafaqimin e rezultateve në forume shkencore të hapura, për organizimin e kuvendeve të studimeve ilire dhe shqiptare, jo vetëm në fusha të veçanta, por edhe me një platforme koordinuese për të gjitha fushat e albanologjisë marrë së bashku, duke konsideruar se, krahas objektit të pavarur të shkencave shqiptare sipas fushave, ekziston edhe një objekt përbashkues i tyre. Mungesa e kritikës shkencore ka qenë shkak që në mjaft raste debatet të rrëshqasin prej regjistrit shkencor në atë të atdhetarizmit retorik.

Në kushtet kur jo vetëm prej “*shkencëtarëve të universitetit të Google-it*”, por edhe nga profesorë e akademikë, shpallet si parim që shkenca nuk ka atdhe dhe albanologjia nuk ka pse të ekzistojë; në kushtet kur globalizmi ka krijuar një raport të ri midis eurocentrizmit dhe etnocentrizmit, mbajtja e një kuvendi të studimeve shqiptare nga nevojë është shndërruar në përgjegjësi.

I. Një historik i shkurtër i albanologjisë: arritje dhe probleme

I.A. Fillimet e albanologjisë ndër shqiptarë

Albanologjia si degë e shkencave shoqërore lindi si nevojë për t’u marrë me studimet e historisë së shqiptarëve, për t’u dhënë zgjidhje çështjeve të rëndësishme të etnogjenezës së tyre, gjuhës, kulturës, trashëgimisë materiale e shpirtërore, zakoneve, traditave, institucioneve juridike e politike të tyre.

Studime monografike për historinë e albanologjisë dhe në mënyrë të veçantë cikli i konferencave kushtuar studimeve albanistike në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në arealin e gjermanishtes dhe në Itali, organizuar nga Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë, kanë

mundësuar evidentimin e shkollave, arritjeve, zhvillimeve, prirjeve dhe dukurive të shfaqura në këtë dije në Europë dhe në Botë gjatë shekullit XX e më këndeje.

Është pranuar gjerësisht që, në Shqipëri, *studimi i historisë, gjuhës e kulturës shqiptare është i lidhur ngushtësisht me periudhën e Rilindjes Kombëtare*. Megjithatë, përpjekjet e para në drejtim të studimeve albanologjike ndeshen mjaft më herët. Marin Barleti, me veprat e tij *Mbi rrethimin e Shkodrës* (1504) e sidomos *Histori e jetës dhe e veprave të Skënderbeut, Princ i Epirotëve* (1510), përtej stilit panegjirik, na ofron një rrëfim historik për heroin dhe epokën e tij të mbështetur në bibliografi e, në ndonjë rast, edhe në të dhëna arkivore. Në të njëjtin vit, Gjon Muzaka do të hidhte në letër *Kujtesën e shkurtër të pinjollëve të shtëpisë sonë Muzaka*, dorëshkrim që u gjet dhe u botua më se 350 vjet më vonë nga historiani gjerman Karl Hopf. Me një vërtetësi të rrallë, Gjon Muzaka jep dëshmi unikale për familjen e tij, por edhe për Arianitët, Dukagjinët, Balshajt e sidomos Kastriotët, në shekujt XIV-XV. Një tjetër bashkëkohës e bashkëlufëtari i Skënderbeut, Dhimitër Frangu, e përshkroi epopenë e heroit në librin *Komentar për punët e turqve dhe të zotit Gjergj Skënderbe, princ i Epirit*, shkruar në latinisht, por e njohur nëpërmjet përkthimit italisht, botuar në vitin 1539. Në këtë vepër gjenden disa hollësi për jetën e veprën e Skënderbeut, që mungojnë tek i pari.

Një interes të posaçëm për sinjalizimin, seleksionimin, mbledhjen e interpretimin e të dhënave historike, gjuhësore, etno-kulturore e deri epigrafike treguan në shek. XVII prelatë të ditur katolikë, si Mark Skurra, Pjetër Mazrreku, Nikollë Mekajshi, Pjetër Bogdani, Frang Bardhi. Pjetër Mazrreku, arqipeshkv i Tivarit, në një sprovë të tij mbi origjinën e shqiptarëve (1633) hedh poshtë tezën e ardhjes së tyre nga Albania e Kaukazit, që ishte hedhur nga papa Piu II në vitet 1450. Sipas Mazrekut, *shqiptarët ishin pasardhësit e banorëve të vjetër iliro-maqedonas të Ballkanit* dhe për të pohuar këtë, ai sjell si provë fjalët e shumta latine e greke që kanë depërtuar në shqipen pikërisht si rezultat i fqinjësisë së hershme të tyre me këta popuj. Nga ana e tij, Frang Bardhi, me *fjalorin e tij latinisht-shqip* (1635) e me veprën apologjike mbi Gjergj Kastriot-Skënderbeun (1636), ku mbi një bazë solide të dhënash bibliografike, kronikale e arkivore hedh poshtë pretendimin e autorit sllav Ivan Tomku mbi kinse një origjinë sllave të Heroit, *mund të konsiderohet një pararendës i albanologjisë moderne*. Kjo e fundit, gjithsesi, **si dije e brendshme, merr formën e një fushe të veçantë të dijes e të kërkimit shkencor në kohën e lëvizjes epokale të Rilindjes Kombëtare**. Në kushtet e vështira të Shqipërisë, ishte një gjë e pritshme, që interesimi për origjinën e shqiptarëve, për historinë, gjuhën e kulturën e tyre të shfaqej më së pari tek ngulimet shqiptare jashtë atdheut.

Shprehje e një lëvizjeje kulturore e kombëtare ishte në Italinë e Jugut themelimi i dy institucioneve të arsimit e kulturës arbëreshe, Kolegjit Corsini i themeluar në San Benedetto Ullano të Kalabrisë më 1732, dhe i Seminarit Arbëresh në Palermo (1734). Ky fakt shënoi kthesë vendimtare në veprimtarinë kulturore e shkencore mes arbëreshve. Një plejadë e tërë studiuesish të formuar aty, si Giorgio Guzzetta,

Francesco Crispi, P. Pompilio Rodotà, Nicolò Chetta, Vincenzo Dorsa, Demetrio Camarda, Jeronim de Rada ia kushtuan veprën e tyre studimit të historisë, të gjuhës e të etnokulturës shqiptare. Në veprën *Bisedë mbi origjinën, zakonet e gjendjen aktuale të kombit shqiptar* (1807), autori Angelo Masci *hedh poshtë në mënyrë më të plotë e të mbështetur teorinë e origjinës së shqiptarëve nga “albanët” e Kaukazit*, duke provuar se mes shqipes dhe gjuhës gjeorgjiane *mungon çfarëdo lidhje e ngjashmëri*. Si shumica e autorëve arbëreshë që e pasuan, A. Masci mbrojti tezën sipas së cilës shqiptarët janë pasardhës të pellazgëve, ardhur deri aty nëpërmjet ilirëve. Hershmerinë e tyre në këto troje, sipas tij, e vërtetojnë latinizmat e shumta arkaike në gjuhën shqipe. Ide të ngjashme i kishte avancuar qysh në 1633 edhe Pjetër Mazrreku, arkipeshkëv i Tivarit. Por Masci shkon përtej Mazrrekut duke përdorur me kompetencë argumente gjuhësore. Ai nuk mjaftohet të pohojë *njësinë e ilirëve me maqedonasit e epirotët*, por edhe tenton ta provojë atë duke vendosur në plan krahasues elementë të gjuhës. Vepra e Angelo Masci-t u çmua shumë nga gjeografi danez P. Malte-Brun, i cili e përktheu dhe e përfshiu atë në vëllimin e tretë të serisë *Annales des voyages de la géographie et de l’histoire* (1808).

Në Shqipëri, periudha e Rilindjes Kombëtare shënoi një ringjallje të interesit për studimin e historisë, gjuhës e trashëgimisë kulturore e shpirtërore të popullit shqiptar. Autorë si Konstantin Kristoforidhi, Sami Frashëri, Jani Vreto, Pashko Vasa, Zef Jubani, Thimi Mitko e ushtruan talentin e pasionin e tyre duke botuar histori e skica historike, fjalorë, fjalë të urta, këngë e përralla shqiptare. Veç karakterit të mirëfilltë studimor, botime të tilla merrnin shtysë edhe nga angazhimi patriotik i autorëve, të cilët synonin të ndriçonin e t’i tregonin publikut shqiptar dhe atij të huaj vlerat origjinale historike e kulturore, që i bënin shqiptarët një komb të formuar. Më vonë, studime më të thelluara në fushën e historisë kryen Tef Curani (*Të ndodhunat e Shqypnis*, 1898) e Ndoc Nikaj (*Historia e Shqypnis*, 1902). Në funksion të sfidave të vështira me të cilat përballohej vendi gjatë Luftës I Botërore e pas saj, Mithat Frashëri, Mehmet Konica, Kostë Çekrezi, Kristo Dako, Mehdi Frashëri, Xhafer Belegu e të tjerë shkruan trajtime të veçanta historiko-diplomatike, ku një vend qëndror zinte Lidhja e Prizrenit dhe lufta e saj për tërësinë territoriale të Shqipërisë. Më vonë, Fan Noli e Athanas Gegaj i *dhanë historiografisë moderne shqiptare dy vepra të çmuara mbi jetën e veprën e Gjergj Kastriot-Skënderbeut*, të botuara përkatësisht në 1921 e 1938. Ribotimi i vitit 1947 i veprës *Gjergj Kastriot-Skënderbeu* të Fan Nolit, thellësisht e ripunuar, *shënon edhe hopin që ndan një vepër të shkruar për qëllime divulgative e qytetare, siç ishte botimi i vitit 1921, nga një vepër e mirëfilltë shkencore*. Nuk munguan, ndërkohë, botime studiuesish të veçantë edhe në fushën e gjuhës, e më shumë të letërsisë. Të tilla botime ishin *Literatyra shqype* e Justin Rrotës (1925) dhe *Elemente të gjuhës e të literaturës shqipe* e Eqrem Çabejt (1936).

Për një periudhë të gjatë, në mungesë të institucioneve shkencore, rolin e katalizatorit të mendimit shkencor mbi studimet shqiptare u munduan ta luajnë botime periodike, si revistat *Albania*, *Hylli i Dritës*, *Leka*, *Dituria* etj., ku shkruan *pendë të shquara e me kontribute në fushën e albanologjisë*, si Faik Konica, Justin Rrota,

Pashk Bardhi, Gjergj Fishta, Karl Gurakuqi, Aleksandër Xhuvani, Mati Logoreci, Eqrem Çabej, Marin Sirdani, Gjergj Pekmezi, Kostaq Cipo, Nikollë Gazulli, Mit'had Frashëri (Lumo Skëndo), Mustafa Kruja (Shpend Bardhi) etj.

I.B. Fillimet e studimeve shqiptare tek të huajt

Albanologjia jashtë vendit u themelua në klimën europiane të iluminizmit dhe romantizmit nacional dhe gjuhësor. Në epokën e Romantizmit, kontaktet e rastësishme me shqiptarë, si në Shqipëri, ashtu edhe në Greqi, nxitën interesin e mjaft personaliteteve të kulturës europiane, të cilët filluan të flasin për ta në shkrimet e tyre. Ky ishte rasti i poetit të njohur anglez George Gordon Byron, i Lordit Beaconsfield, që më vonë u bë kryeministër i Anglisë, i shkrimtarit e diplomatit francez François-René de Chateaubriand dhe i plot të tjerëve. Shkrimet e tyre për shqiptarët, historinë e kulturën e tyre, nxitën dijetarë të ndryshëm të studiojnë më në thellësi këtë popull të panjohur. Anglezët John Cam Hobhouse e William Martin Leake, që vizituan Greqinë në fillim të shek. XIX kanë lënë shënime interesante mbi gjuhën, mënyrën e jetesës, zakonet e historinë e shqiptarëve. Në mënyrë të veçantë, Leake në librin e tij *Kërkime në Greqi* (1814), botoi një fjalor greqisht-anglisht-shqip, si dhe studime origjinale mbi strukturën e gramatikën e gjuhës shqipe. Nga ana e tij, François Pouqueville, me gjithë paragjykimet që rridhnin nga misioni i tij zyrtar dhe nga marrëdhëniet e tendosura me Ali pashë Tepelenën, jep të dhëna interesante mbi historinë, gjuhën, traditat e mënyrën e jetesës së shqiptarëve (*Udhëtim në More, në Konstandinopojë e Shqipëri*, 3 vëll., 1805; *Udhëtim në Greqi*, 5 vëll. 1820-1822).

Me rëndësi të madhe për historinë e etnologjinë e Epirit në shek. XIV-XVIII janë dy kronika të botuara prej tij, *Kronika e Dropullit* dhe *Kronika e Janinës*. Së bashku me një tjetër kronikë të shek. XV botuar në 1974 nga G. Schirò, *Kronika e Tokove të Qefalonisë*, këto burime historike *provojnë vendin dhe rolin e shqiptarëve në demografinë e në zhvillimet politike të Epirit në shek. XIV-XV*. Kontakti me shqiptarët e Greqisë e të Italisë nxiti studiues të ndryshëm të hulumtojnë mbi origjinën, historinë, gjuhën e pasurinë shpirtërore të tyre. Në vitin 1855, gjermani Karl Reinhold, me detyrë mjek i flotës greke, botoi librin *Netë pellazgjike*. Bëhet fjalë për një pëmbledhje këngësh, përrallash, fjalësh të urta, gjëagjësash të mbledhura nga marinarët e flotës greke, që ishin në shumicë arbëreshë (*arvanitas*). Me gjuhën e etnokulturën e arbëreshëve të Greqisë, e po ashtu të Italisë, u mor edhe gjuhëtari i shquar austriak Gustav Meyer, një nga themelvënësit e albanologjisë. Pas tij, studime mjaft të arrira në fushën e gjuhës, të folklorit e toponimisë të ngulimeve shqiptare ka realizuar studiuesi arbëresh nga ishulli i Salaminës, Petro Furiqi (*Dialekti i shqipes së Atikës në Greqi*, 1929; *Kontribut në toponiminë e Atikës*, 1933). Ka shkruar për historinë e Prevezës, duke vërtetuar se emri i qytetit ka ardhur deri sot nëpërmjet gjuhës shqipe. Ka studiuar gjithashtu toponiminë historike të Moresë, duke dalë në konkluzionin se shqiptarët janë ngulur në Morë qysh në

shek. X. Veprën e Furiqit e ka vazhduar në dekadat e fundit Titos Jochalas, autor i shumë veprave mbi zbritjen e shqiptarëve në Greqi në Mesjetë, mbi gjuhën e dialektet e shqipes, mbi fjalorin e Marko Boçarit, mbi Gjergj Kastriot-Skënderbeun, mbi dialektin shqip të Thrakës dhe veprën e fundit dyvëllimëshe mbi arbëreshët e Moresë (*Ta Arvanitika*, 2010).

Nga ana e tij, francezi Louis Hyacinthe Hecquard, konsull i Francës në Shkodër në vitet 1850, botoi një vepër të çmuar mbi Shqipërinë e Epërme, me studime të veçanta mbi ndarjet gjeografike e fisnore, mbi organizimin shoqëror e politik të malësisë, mbi doket, zakonet e folklorin e Gegërisë, nga Tirana deri në Tivar (*Një histori e përshkrim i Shqipërisë së Epërme ose i Gegërisë*, 1858). Por studimet albanologjike për Veriun shqiptar gjetën një personalitet të jashtëzakonshëm tek studiuesi austro-hungarez Franz Nopcsa. Gama e hulumtimeve të tij shqiptare pas ekspeditave të gjata në Shqipërinë e Veriut, shtrihej nga gjeologjia, historia, etnologjia, gjeografia, institucionet. Botimet e tij fillojnë me *Shqipëria veriore katolike* (1907), *Prej Shalës në Kelmend* (1910), *Shtëpia dhe këshilli familjar në Shqipërinë veriore katolike* (1912). Veprat e mëvonëshme të tij marrin një karakter të mirëfilltë shkencor. Në 1925 ai botoi *Ndërtimet, zakonet dhe monumentet historike të Shqipërisë së Veriut* dhe në 1932 monografinë e tij kryesore *Gjeologjia e gjeografia e Shqipërisë së Veriut*. Nga veprat e tjera të mbetura në dorëshkrim, në 1996 u botua *Bashkësitë fisnore të Shqipërisë së Veriut*, ndërsa mbeten në dorëshkrim *Botëkuptime fetare, doke e zakone*, *Poezia e Kolec Markut*, një volum lirikash me 160 poezi, *Studime dialektesh dhe kujtimet e autorit*, të cilat u botuan në vitin 2007 në Tiranë me titullin *Udhëtime në Ballkan* dhe përmbajnë mjaft vëzhgime nga jeta në malësinë shqiptare.

Nga vitet 1430, kur qytetet bregdetare të Shqipërisë u vizituan nga epigrafisti italian Ciriaco d'Ancona, e deri në shek. XIX, kemi vetëm njoftime të shkëputura mbi mbishkrime të vjetra e objekte arkeologjike të vendit tonë. Me francezët Léon Heuzey e Honoré Daumet (*Mision arkeologjik i Maqedonisë*, 1876) e sidomos me austriakët Carl Patsch, Camillo Praschniker e Arnold Schober (*Sanxhaku i Beratit në Shqipëri*, 1904; *Myzeqeja e Mallakastra*, 1920; *Kërkime arkeologjike në Shqipëri e Mal të Zi*, 1919) monumentet e sitet arkeologjike në Shqipëri bëhen objekt studimi i veçantë. Në gjysmën e parë të shek. XX zbulohen Butrinti (Ugolini) dhe Apollonia (Léon Rey). Me rëndësi të posaçme për kulturën materiale shqiptare në periudhën e hershme të Mesjetës ishte zbulimi i varrezës së Komanit, pranë kalasë së Dalmacës, ku në vitin 1961 u kryen gërmime sistematike nga arkeologët shqiptarë Hëna Spahiu e Skënder Anamali.

I.C. Albanologjia në vendet gjermanike

Kuriozitet të veçantë shkencor ngjallën shqiptarët, me gjuhën e historinë e tyre, tek dijetarë eruditë të botës gjermanike. Gottfried Wilhelm von Leibniz ishte ndër të parët që, në kapërcim të shek. XVII-XVIII, u interesua dhe fitoi njohuritë e para për gjuhën shqipe, prej nga ku hodhi edhe *idenë e origjinës së saj nga ilirishtja*. Disa

dekada më vonë, historiani suedez Johann Thunmann (1774) iu përkushtua çështjes së origjinës së shqiptarëve, duke i parë edhe ai si pasardhës të drejtpërdrejtë të fiseve ilire në Ballkanin. Në qasjen e tij me albanologjinë nuk duket të ketë qenë pa ndikim njohja e Thunmann-it me voskopojarin e ditur Kostë Xhehani. Joseph Xylander (*Gjuha e Shqiptarëve*, 1835) u përpoq, me mjetet e pakta që dispononte, të vërtetonte karakterin indoeuropian të gjuhës shqipe, gjë që pas tij e provoi në mënyrë bindëse Franz Bopp. Në veprën e tij *Mbi gjuhën shqipe dhe lidhjet e saj të afërsisë* (1854), Bopp bëri një analizë historike të thellë të strukturës gramatikore e të disa elementëve të leksikut të gjuhës shqipe. F. Bopp zbuloi një varg elementesh të përbashkët të shqipes me gjuhët e tjera indoeuropiane dhe vërtetoi në mënyrë përfundimtare se ajo bën pjesë në familjen gjuhësore indoeuropiane, ku ze një vend të veçantë si gjuhë më vete. Vepra e F. Bopp ishte një **gur themeli në studimin e historisë së gjuhës shqipe**. Ishte një fat i madh, që pas tij u morën me studimin e problemeve të ndryshme të shqipes në plan të krahasuar historik përfaqësues të shquar të pothuaj të gjitha shkollave të lingistikës, F. Miklosich, G. Meyer, H. Pedersen, G. Weigand, P. Kretschmer, A. Seliščev, M. Lambertz, C. Tagliavini, M. Roques, P. Skok, H. Barić. Vepra e tyre, e kurorëzuar në shek. XX nga N. Jokl, e vuri gjuhësinë historike shqipe në rrugën e zgjidhjes së shumë çështjeve themelore. Kështu, nga pikëpamja gjenealogjike u provua se shqipja është gjuhë indoeuropiane dhe u përcaktua në vija të përgjithshme vendi i saj i veçantë në këtë familje gjuhësore në bazë të analizës së strukturës së saj fonetike, gramatikore dhe leksikore. Mbi bazën e kërkimeve të shumanshme historiko-linguistike **u formuluan tri hipoteza të gjenezës së shqipes: hipotezat e prejardhjes ilire, trake dhe trako-ilire**. Vazhdimësia iliro-shqiptare u mbrojt fort nga gjuhëtarë të nivelit të Gustav Meyer, Paul Kretschmer, H. Pedersen, N. Jokli etj.

Përparime të dukshme shënuan edhe studimet në lëmin e historisë së shqiptarëve. Jakob Philipp Fallmerayer hoqi i pari një skicë të historisë së Gjergj Kastriotit Skënderbeut në kuadrin e veprës *Elementi shqiptar në Greqi*, 3. vëll., 1857-1861. Fallmerayer i vlerëson shqiptarët si një popull me vitalitet të madh dhe *fanatikisht liridashës*. Në një vepër më të herëshme (*Histori e gadishullit të Moresë gjatë Mesjetës*, 2 vëll., 1830-1836) ky autor nënvizoi rëndësinë e madhe të pranisë shqiptare në Peloponez, ku të parët e tyre u ngulitën masivisht në fund të shek. XIV. Një histori të Shqipërisë mesjetare, duke shfrytëzuar gjerësisht dokumente arkivore, shkroi historiani Karl Hopf (*Histori e Greqisë prej fillimit të Mesjetës deri në kohën tone*, 2 vëll. 1868). Hopf është, gjithashtu, botues i disa dorëshkrimeve të çmuara, mes të cilëve *Kujtesë e shkurtër e pinjollëve të shtëpisë sonë Muzaka*, shkruar në 1510 nga bashkëkohësi i Skënderbeut, Gjon Muzaka. Ky është **një nga dokumentet më të çmuara për historinë e prosopografinë mesjetare shqiptare**. Hopf, dhe pas tij albanologu i madh G. Hahn, me plot të drejtë e kanë vlerësuar veprën e Gjon Muzakës si *perla e materialeve tona për Shqipërinë*.

Një vend të veçantë nderi zë në studimet albanologjike emri i Johann Georg von Hahn, autor i veprave *Udhëtime në trevat e Drinit e Vardarit* (1867), *Udhëtim nga*

Belgradi në Selanik (1868) e sidomos i veprës poliedrike *Studime shqiptare* në tre vëllime (1854), që përfaqëson një kulm të studimeve albanologjike. Sot, pas 150 vjetësh, **ky studim i Hahn-it mbetet një vepër klasike e albanologjisë**, një mjet i domosdoshëm pune për historianët, gjuhëtarët, gjeografët, arkeologët dhe studiuesit e kulturës materiale e shpirtërore të popullit shqiptar. Hahn mbron tezën se shqiptarët janë banorë të kahershëm të Ballkanit, të lidhur gjenetikiisht me ilirët, e akoma më tej, me pellazgët.

Në vitin 1899 autori dalmat Giuseppe Gelcich botonte *Zeta dhe dinastia e Balshajve*, duke çuar përpara përpjekjen e bërë gjysmë shekulli para tij nga J. Ph. Fallmerayer për të shkruar një histori të shkurtër të kësaj familjeje. Emra të tillë i dhanë studimeve albanologjike një prestigj e autoritet të tillë, që pas tyre - në shek. XX - në fushën e albanologjisë u shfaq e u afirmua një gjeneratë e re studiuesish, austriakë e gjermanë, si gjuhëtari Norbert Jokl, arkeologu e historiani i artit mesjetar Theodor Ippen, etnologu Franz Nopcsa e padyshim historianët medievistë Ludwig Thalloczy, Konstantin Jireček e Milan Šufflay. Me veprat e tyre *Studime iliro-shqiptare* (1916), *Histori e Serbëve* (1911), *Serbët dhe shqiptarët* (1925), *Qytete e kështjella të Shqipërisë në Mesjetë* (1924), e mbi të gjitha botimit mjeshtëror dokumentar *Akte e dokumente për historinë mesjetare të Shqipërisë* në 2 vëllime (1913-1918), **këta dijetarë e ngritën albanologjinë në nivelin më të lartë të kërkimit shkencor**. Në mënyrë të veçantë M. Šufflay **e gdhendi në mënyrë lapidare vendin e rolin e shqiptarëve në historinë e kulturën e popujve ballkanikë**, duke i përcaktuar ata si një **komb parësor**. *Shqipëria mesjetare*, shprehej Šufflay, mund të quhet me të drejtë një monadë, në të cilën, thuhet si në një pasqyrë, mund të hetohet krejt gadishulli i Ballkanit, me të gjitha shtresëzimet e tij, latine, romane, italike, greke, bizantine, sllave. Punën e kësaj tresheje gjeniale në drejtim të historisë mesjetare të shqiptarëve e vazhduan pas Luftës I Botërore medievistë të shquar të shkollës së Mynihut, Georg Stadtmüller (*Kërkime mbi historinë e hershme të shqiptarëve*, 1942; *Përhapja e vendbanimit të popullit shqiptar në fund të mesjetës dhe në kohën e tashme*, 1937) e Franz Babinger (*Themelimi i Elbasanit*, 1931; *Mbi udhëtimet e Evlia Çelebisë në Shqipëri*, 1938; *Mehmeti II Pushtuesi dhe epoka e tij*, 1953; *Fundi i Arianitëve*, 1960).

I. D. Studimet albanologjike në Shqipëri e në Kosovë pas luftës. Krijimi dhe organizimi i institucioneve

Pavarësisht përpjekjeve individuale, në Shqipëri, para, por edhe edhe pas themelimit të shtetit të pavarur shqiptar e deri në fundin e Luftës II Botërore, nuk u ngritën institucione të posaçme kërkimore-shkencore, që do të organizonin e orientonin veprimtarinë shkencore në fushën e studimeve shqiptare. Në vitin 1940, në kushtet e pushtimit italian, në Tiranë u themelua *Instituti i Studimeve Shqiptare*, i drejtuar fillimisht nga Ernest Koliqi. Anëtarë të këtij instituti ishin studiues shqiptarë nga më të spikaturit e kohës, si dhe një numër studiuesish italianë. Instituti përcaktoi në një kuvend të tij edhe një program pune për

zhvillimin e kulturës kombëtare. Por veprimtaria dhe efektiviteti i këtij instituti ishte e pakët dhe e kushtëzuar nga rrethanat e luftës.

Me mbarimin e luftës, kërkesa për zhvillimin e shpejtë të kulturës dhe të shkencës ishte në shpërpjesëtim të zhdrejtë me kapacitetet e pakta intelektuale, me mungesën e përvojës shkencore, me varfërinë e bibliotekave e mungesën e institucioneve arkivore. Në këtë drejtim u punua për të krijuar parakushtet për një veprimtari kërkimore normale. U angazhuan studiues të afirmuar, që kishin studiuar e punuar në universitete të njohura të Perëndimit para luftës, duke përjashtuar elementë që konsideroheshin kundërshtarë të regjimit. U përgatitën kadro të rinj, fillimisht në universitetet e vendeve ish-socialiste e mandej në Universitetin e Tiranës. Pas viteve 1960 u dërguan edhe në Francë, Itali, Turqi, Greqi, Austri studentë e studiues, që u specializuan në njohjen e gjuhëve të rralla, latinishtes, greqishtes, osmanishtes, sllavishtes së vjetër, gjuhë të domosdoshme pune për drejtime të veçanta të shkencave albanologjike. U punua për krijimin e bibliotekave e arkivave të specializuara dhe për krijimin e institucioneve të mirëfillta kërkimore-shkencore. Kështu, më 1947, u krijua Instituti i Studimeve, i cili, në vitin 1948, u riorganizua nën emrin Instituti i Shkencave, me tre seksione: i gjuhës e letërsisë, i historisë e sociologjisë dhe i shkencave natyrore e biologjike. Prej tij vareshin edhe Biblioteka Kombëtare, Arkivi i Shtetit, Muzeu Arkeologjik-Etnografik etj. Instituti filloi të botojë organin e vet, *Buletin i Institutit të Shkencave*. Në vitin 1955, nga bashkimi i sektorëve të historisë, të gjuhësisë e letërsisë, të sociologjisë e të ekonomisë, u krijua Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, veprimtaria e të cilit në vitin 1957 u integrua në Universitetin e porsathemeluar të Tiranës, në Fakultetin Histori-Filologji. Nga viti 1960 si pjesë e atij fakulteti u bë edhe Instituti i Folklorit, i krijuar atë vit.

Në këtë fazë të parë të riorganizimit të instituteve albanologjike u arrit të mbushej disi zbrazëtia e trashëguar nga a kaluara, duke botuar disa vepra madhore, si *Fjalori i gjuhës shqipe* (1954), *Historia e Shqipërisë* në 2 vëllime (1959, 1965), *Historia e letërsisë shqipe*, në dy vëllime (1959, 1960). Përveç akteve të konferencave e botimeve monografike, pjesa kryesore e prodhimit shkencor albanologjik botohej në periodikët shkencorë, numri i të cilëve erdhi duke u rritur. Nga viti 1957 deri në 1963 pa dritën e botimit revista *Buletin i USHT, Seria e Shkencave Shoqërore*. Duke nisur nga vitit 1963, filloi botimi i periodikëve shkencorë *Studia Albanica, Studime Historike, Studime Filologjike, Etnografia Shqiptare, Kultura Popullore, Iliria e Monumentet*, ky i fundit organ i Institutit të Monumenteve të Kulturës.

Një moment shumë i rëndësishëm i prezantimit e ballafaqimit shkencor u bënë konferencat kombëtare e ndërkombëtare. Kështu, në vitin 1952 Instituti i Shkencave organizoi konferencën kombëtare *Formimi i kombit shqiptar dhe fillimet e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare* e në vitin 1955 sesionin shkencor kushtuar 400-vjetorit të botimit të *Mesharit* të Gjon Buzukut. Ngjarje kulmore ishte **Konferenca e Parë e Studimeve Albanologjike**, e organizuar në 50-vjetorin e Shpalljes së Pavarësisë

(nëntor 1962), ku, veç studiuesve shqiptarë, morën pjesë studiues të huaj nga më të njohurit të fushave të gjuhësisë, historisë, arkeologjisë e antropologjisë, si Karl Treimer, Vittore Pisani, Gunnar Svane, Henri Boisin, Franz Babinger, Domenico Mustilli, Johann Irmscher, Jan Kabrda. Njëpërmjet kumtesave e diskutimeve të gjalla të zhvilluara gjatë ditëve të konferencës, u shënua një progres i dukshëm në trajtimin e thelluar të një game të gjerë të problemeve të albanologjisë. Në janar 1968, në 500-vjetorin e Gjergj Kastriot-Skënderbeut u mbajt **Konferenca e Dytë Albanologjike**. Ishte një ballafaqim shkencor i suksesshëm me problematikën e gjerë të figurës e epokës së Skënderbeut, ku, krahas studiuesve të vjetër e të rinj shqiptarë, dhanë kontribut të çmuar edhe studiuesit e njohur Freddy Thiriet, Francisc Pall, Alain Ducellier, Bogumil Hrabak, Halil İnalçik, Karl Treimer, Vladimir Georgiev, Györgi Daniel etj. Me rastin e këtij përvjetori, përveçse në Tiranë, u organizuan konferenca të mëdha shkencore edhe në Itali e në Kosovë, ku studimet albanologjike morën një hov të panjohur më parë. Nga ai moment, vendosen edhe lidhje të ngushta bashkëpunimi dhe realizohen shkëmbime, pjesmarrje në tubime shkencore dhe ekspedita mes studiuesve shqiptarë nga Shqipëria, Kosova e Italia, ku më vonë u përfshinë edhe studiues arbëreshë nga Greqia.

Në vitet e mëpasme u intensifikuan tubimet shkencore për degë, periudha e çështje të veçanta. Në vitet 1972 e 1985 u mblodhën **Kuvendi i Parë dhe i Dytë i Studimeve Ilire**. Më tej u zhvilluan konferenca e studimeve etnografike (1974), konferenca për *Lidhjen Shqiptare të Prizrenit* me rastin e 100-vjetorit të themelimit të saj (1978), simpoziumi ndërkombëtar për *epikën legjendare shqiptare* (1982), konferenca për *Pjetër Bogdanin* në 300-vjetorin e vdekjes (1989); konferenca kushtuar *Principatës së Arbërit* (1990), konferenca ndërkombëtare *E vërteta mbi Kosovën* (1993), konferenca ndërkombëtare *Dy mijë vjet krishtërim shqiptar* (2000), konferenca mbi *Gjergj Kastriot-Skënderbeun* (2008). Në vitin 2018, në formatin *lectio magistralis*, u mbajtën dhe u diskutuan rreth 40 referate të studiuesve më të njohur shqiptarë e të huaj mbi aspekte të veçanta të jetës, veprës dhe epokës së Skënderbeut, si dhe një konferencë ndërkombëtare mbi heroin.

Në gjysmën e dytë të shekullit XX albanologjia mori karakter institucional edhe në Kosovë, me themelimin e Universitetit të Prishtinës, të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, të Institutit Albanologjik dhe të instituteve të tjera¹.

I.E. Studime të fushën e gjuhësisë e të letërsisë shqipe

Në fushën e gjuhësisë dhjetëvjeçarët e fundit janë bërë hapa të rëndësishëm në zhvillimin e mëtejshëm e studimeve gjuhësore të konsoliduara gjatë gjysmës së dytë të shek. XX, duke u thelluar në aspekte të veçanta të studimeve në rrafshe të ndryshme, si dhe duke çuar më përpara me metoda të reja studimet në disiplina të lëvruara edhe më parë. Arritje janë shënuar në të gjitha disiplinat gjuhësore, si në

¹ Për t'u plotësuar.

rrafshin diakronik edhe në atë sinkronik: morfologji, sintaksë, fonetikë, dialektologji, leksikologji, leksikografi, semantikë, filologji.

Në rrafshin diakronik, një bazë të rëndësishme për historinë e formimit të gjuhës shqipe kanë vendosur studimet e E. Çabejt, M. Domit, Sh. Demirajt, I. Ajetit etj., si dhe të albanologëve të huaj Eric Hamp, Vittore Pisani, Radoslav Katičić, Carlo de Simone, Haralambie Mihăescu, Gerhard Rohlfs etj. *për historinë e gjuhës shqipe, vendin dhe kohën e formimit të saj, marrëdhëniet e shqipes me gjuhët ballkanike, problemet e ilirishtes, si onomastika me prejardhje ilire në trevat shqiptare, paralelizmat shqiptaro-ilire në fushën e fjalëformimit, përkimet e ilirishtes me mesapishten* etj. Mbas viteve 1990 nuk shënohen përparime të dukshme në fushën prejardhjes së shqipes nga një prej gjuhëve të Ballkanik antik, për sa kohë dija nuk është pasuruar me materiale të reja gjuhësore nga këto gjuhë. Një përpjekje në këtë drejtim është ajo e historianit Gottfried Schramm (1994, 1999) ***për të nxjerrë prejardhjen e shqiptarëve nga fisi trakas i besëve***, i cili emigroi nga Trakia lindore në trojet e Arbërit aty nga shek. IX për t'u shpëtuar përndjekjeve fetare, tezë e kontestuar nga studiuesit, veçanërisht nga B. Demiraj (2010) me argumente gjuhësore. Por tezës së Schramm-it i mungojnë gjithashtu argumentat arkeologjike e historike, tek të cilat nuk ka gjurmë për një shpërngulje të tillë. E njëjta vërejtje mund të bëhet edhe për ***përpjekjet më të reja të albanologëve të huaj për formimin e gjuhës shqipe dhe etnogjenezën e shqiptarëve të mbështetura vetëm në analiza gjuhësore***. Siç e kanë përcaktuar albanologët e shquar shqiptarë Aleks Buda e Eqrem Çabej, ***etnogjeneza e shqiptarëve është një problem kompleks ndërdisiplinor ku duhet të konvergojnë përpjekjet e disa degëve të albanologisë: gjuhësia, historia, arkeologjia, antropologjia kulturore***.

Në fushën e etimologjisë me rëndësi është përcaktimi i një metode të drejtë studimi, i parimeve dhe kriterëve për gjurmimin e etimonit të fjalës, për të cilën meritë të veçantë ka E. Çabej, edhe me zbatimin në studimet e tij etimologjike të një metode ndërdisiplinore në hetimin e jetës dhe historisë së fjalës në mjedisin gjuhësor e kulturor të popullsisë që e flet. Sukses shkencor është botimi i 7 vëllimeve të *Studimeve etimologjike në fushë të shqipes*, lënë pjesërisht në formë dorëshkrimi të papërfunduar nga autori, E. Çabej. Ribotimi i përmirësuar i kësaj vepre madhore të etimologjisë shqipe i ndërmarre nga Akademia e Shkencave është një homazh për korifeun e albanologjisë shqiptare dhe një dhuratë e çmuar për studiuesit dhe për publikun e interesuar.

Arritje të rëndësishme janë shënuar edhe ***në fushën e shtresimit historik të leksikut të shqipes dhe të marrëdhënieve me gjuhët e tjera*** me të cilat shqipja ka qenë në kontakt gjatë historisë së saj. Bazat e studimit të huazimeve latine, italiane, greke, turke, sllave në shqipen i patën vënë albanologët e shquar të shekullit XIX, që nga F. Miklošić-i e G. Meyer-i, më pas ata të shek. XX si R. Helbig, A. M. Seliščev, A. Desnickaja, H. Haarmann, N. Boretzky, G. Bonnet, G. Uhlisch, G. Svane etj. Studiuesit shqiptarë kanë dhënë gjithashtu ndihmesë të veçantë për këto pjesë të leksikut të shqipes, si: E. Çabej *për karakteristikat e*

huazimeve latine të shqipes e për kronologjinë e huazimeve turke në shqipen; S. Mansaku për huazimet nga greqishtja e vjetër në shqipe dhe për përshtatjen e elementit latin në shqipe; studiuesit nga Kosova I. Ajeti, Q. Murati për studimin e marrëdhënieve shqiptaro-sllave dhe sidomos studimet monografike të A. Omarit e Xh. Yllit, me kontribute për krijimin e një korpusi të sllavizmave dhe vendin e tyre në gjuhën shqipe, për përhapjen gjeografike të sllavizmave në hapësirën gjuhësore të shqipes ku del në pah karakteri i tyre kryesisht periferik e lokal. Në këto studime nuk është lënë mënjanë edhe ndikimi i gjuhës shqipe në të folmet sllave të jugut (I. Ajeti, R. Ismajli, S. Hoxha, M. Blaku, A. Omari). Për studimin e italianizmave vlejné të përmenden punimet e G. Lafes (2002) dhe K. Jorgaqit (2001). Me studimin e shqipes në kontekstin e gjuhëve ballkanike është marrë posaçërisht R. Ismajli (Prishtinë 2015). Lidhur me marrëdhëniet e shqipes me gjuhët ballkanike, u organizua në Prishtinë në vitin 2011 nga Akadema e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës një konferencë ndërkombëtare me temë *Shqipja dhe gjuhët ballkanike*. Një vepër e rëndësishme për gramatikën e krahasuar të gjuhëve ballkanike me fokus në gjuhën shqipe është vepra e fundit e albanologut të ndjerë W. Fiedler (Prishtinë 2019).

Kontribute janë shënuar edhe nga fusha e toponimisë, etnonimisë, patronimisë e paronimisë shqiptare në funksion të argumentimit sa më shkencor të problemit të autoktonisë së shqiptarëve (I. Ajeti, L. Dodbiba, K. Luka, D. Luka, S. Mansaku).

Në dhjetëvjeçarët e fundit **ka shënuar arritje të rëndësishme filologjia e teksteve shqipe**, sidomos ajo e teksteve të vjetra shqipe e arbëreshe. Studiuesit shqiptarë e arbëreshë kanë kryer një punë voluminoze e shembullore, duke shkuar në hullinë metodologjike të çelur nga mjeshtri Çabej e me parimet e kriteret e parashtruara që në vitin 1959 për botimin e teksteve të vjetra shqipe dhe sidomos me punën paradigmaticke në botimin kritik të *Mesharit* të Gjon Buzukut. Tashmë gjithë kjo punë intensive ka dhënë frytet e veta, duke mbuluar me botime kritike filologjike thuajse gjithë letërsinë e vjetër shqipe dhe pjesën kryesore të letërsisë arbëreshe, ku spikasin punimet e G. Svanes, B. Demirajt, M. Mandalà-së, F. Altimarit, I. Fortinos, R. Ismajlit, A. Hetzerit, A. Omarit, G. Gurgës, T. Toskës etj. Kontribut i çmuar janë sidomos botimet e veprave në dorëshkrim, të panjohura më parë nga publiku, por me rëndësi madhore për historinë e lëvrimin të shqipes dhe leksikun historik të saj, siç është *Fjalori italisht-shqip* i Francesco Maria da Lecces. Vazhdojnë hulumtimet arkivore për kërkimin e dorëshkrimeve të panjohura në shqipen e shekujve XVIII-XIX dhe botimin e tyre kritik e filologjik, sidomos nga B. Demiraj, i cili së fundi e ka kthyer vëmendjen nga shkrimet e vjetra shqipe të arealit të toskërishtes (shek. XVIII), kryesisht të shkruara me alfabetin grek, duke realizuar botime kritike e filologjike që plotësojnë kuadrin e trashëgimisë letrare shqipe të botuar me kritere filologjike bashkëkohore. Prurjet e reja në kërkimin filologjik dhe edicionin kritik të trashëgimisë kulturore të shkrimit shqip ndjekin një metodë sa tradicionale e të konsoliduar prej shekujsh në filologjinë botërore, aq edhe bashkëkohore në zbatimin e metodave të reja të numerizimit dhe përpunimit kompjuterik të materialit

gjuhësor të shqipes së vjetër. Këto përparësi kanë mundësuar përfundimin e një korpusi gjithëpërfshirës të leksikut historik të shqipes, si bazë solide për realizimin e suksesshëm të projekteve afatgjata, siç është *Fjalori digjital filologjik-etimologjik i shqipes së vjetër* (shek. XV-XVIII), një punë pioniere në fushën e leksikografisë shqipe, që plotëson mungesën e një fjalori historik dhe etimologjik të shqipes së vjetër. Një nga korpuset më të pasur, ***me mbi 200 milionë fjalë dhe forma të shqipes***, arkivuar në rrugë elektronike dhe me kërkime në terren, është krijuar nga studiues të Akademisë së Shkencave të Rusisë. Studiuesit shqiptarë në Universitetin e Kalabrisë dhe në atë të Sicilisë F. Altimari e M. Mandalà, kanë krijuar ***korpusin e arbërishtes së folur e të shkruar***. Korpuse të ngjashme janë krijuar edhe nga studiues që punojnë individualisht, si B. Kabashi (Gjermani).

Në rrafshin diakronik të studimeve gjuhësore ***shënohen arritje të spikatura në studimet e fonetikës dhe gramatikës historike të shqipes***, ku veprave themelore në këtë fushë të E. Çabejt dhe Sh. Demirajt u shtohen *Fonetika historike* (2007) dhe *Gramatika historike* (2012) e K. Topallit, që përfshin ndihmesat e këtij studiuesi në çështje të ndryshme problematike të fonetikës dhe gramatikës historike të shqipes, krahas pasqyrimin të rezultateve të studimeve paraardhëse në këtë fushë. Një paraqitje e mirë e fonologjisë historike të shqipes gjendet në veprën e J. Matzinger-it mbi tekstin e vjetër shqip të Lekë Matrangës, ku përmbahet edhe një *hyrje në gjuhësinë shqipe* (2006). Për studimin e thelluar diakronik të gramatikës së shqipes kontribute të rëndësishme janë veprat e Besim Bokshit *për evolucionin e fleksionit të sotëm nominal të shqipes* (Prishtinë 1980), *të përemrave vectorë* (Prishtinë 2004), *të pjesores në shqipe në vështrim diakronik* (Prishtinë 2008), si dhe *punimi përgjithësues për periodizimin e ndryshimeve morfologjike të shqipes* (Prishtinë 2010). Kurorëzimin e një pune shumëvjeçare në fushën e fonetikës e gramatikës historike të shqipes e shënoi botimi i *Fjalorit etimologjik të gjuhës shqipe* nga K. Topalli (2017), një sintezë e mendimit dhe arritjeve etimologjike të një plejade të tërë studiuesish e albanologësh, sidomos e studimeve etimologjike të E. Çabejt, dhe e punës intensive vetjake në fushë të etimologjisë shqipe. Ndër albanologët e huaj, përveç etimologjive të krahasuara të E. Hamp, përmendet *fjalori etimologjik i gjuhës shqipe* hartuar e botuar nga V. Orel.

Problemeve të gjuhësisë historike shqipe, të filologjisë së teksteve të vjetra, të ngjarjeve të shënuara historike që kanë shënuar piketa të rëndësishme në historinë e lëvrimin të shqipes e të kulturës së saj, të figurave të shquara që kanë dhënë ndihmesa në zhvillimin e gjuhësisë historike shqipe u janë kushtuar në dhjetëvjeçarët e fundit një numër konferencash shkencore ndërkombëtare, si *Kuvendi i Arbënit* (1703) në 300-vjetorin e mbajtjes së tij, nga dega e albanologjisë e Mynihut (Mynih 2003); konferencat kushtuar *Mesharit* të Gjon Buzukut në 450-vjetorin e tij organizuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë (Tiranë 2005); *Çështje të studimeve diakronike të shqipes*, organizuar nga ASHA e Kosovës dhe ASH e Shqipërisë (Prishtinë 2009); konferencat shkencore kushtuar përvjetorit të E. Çabejt nga ASH dhe ASHAK (Tiranë 2008), të S. Rizës nga Universiteti i Tiranës (Tiranë

2009) e ASH dhe QSA (Tiranë 2009); të M. Camajt nga QSA (Tiranë 1010); konferencat shkencore kushtuar 100-vjetorit të Kongresit të Manastirit (2008); konferencat albanologjike ndërdisiplinore *50 vjet albanologji në universitetin "Ludwig Maximilian" të Mynihut* (Mynih 2011) dhe *Gjuha dhe kultura shqiptare, dimensione kohore dhe hapësinore* (Buçimas 2014), organizuar nga dega e albanologjisë e ULM, Mynih; konferencat shkencore ndërkombëtare me rastin e 200-vjetorit të lindjes së F. Santorit *Franqisk A. Santori dhe trashëgimia gjuhësore e letrare shqipe* etj.

Studimi i dialekteve të shqipes ka qenë një fushë nga më të lëvruarat në gjuhësinë shqiptare të gjysmës së dytë të shek. XX, bazat e së cilës janë hedhur që në vitet 1940 në Qendrën e Studimeve Shqiptare pranë Akademisë italiane të Shkencave me idenë e M. Bartolit për hartimin e një *Atlasi Dialektologjik të gjuhës shqipe*, si dhe me punën e E. Çabejt *për hartimin e pyetësorit dialektologjik të këtij atlas*. Por puna më intensive për hulumtimin e dialekteve të shqipes u krye nga studiuesit shqiptarë në vitet 1960-1980 kur krejt hapësira shqiptare, brenda dhe, për sa që e mundur asokohe, edhe jashtë kufijve, u eksplorua në mënyrë të organizuar dhe sistematike dhe shumica e të folmeve të shqipes u mbuluan me një rrjet të dendur hulumtimesh dhe përshkrimesh të degëzimeve dialektore. Kjo punë gjigante çoi në hartimin e *Atlasit Dialektologjik të Gjuhës Shqipe* (J. Gjinari, B. Beci, Gj. Shkurtaj, Xh. Gosturani, 2007-2008), ***një vepër madhore e gjuhësisë shqiptare***. Puna për studimin e dialekteve nuk mbeti me punimet përshkruese dialektologjike, por u pasua nga studime të thelluara përgjithësuese për dialektet e shqipes dhe tiparet e përbashkëta të tyre, siç ishte vepra e J. Gjinarit *Dialektet e gjuhës shqipe* (1989), e cila zbatonte një metodë të re për atë kohë në studimet sinkronike të shqipes, *metodën strukturore-funksionale të Shkollës së Pragës*, e cila filloi të zbatohet në Shqipëri në vitet 1970.

Mbas një periudhe qetësie në studimet tona dialektologjike pas viteve 1990, kemi një rikthim të vëmendjes në dialektet dhe studimet dialektore me veprën e fundit të B. Becit për strukturën dialektore të shqipes (2016), një punim përgjithësues që sjell një qasje të re në kundrimin e strukturës dialektore të shqipes. Puna për studimet dialektore nuk mund të konsiderohet në asnjë mënyrë e përfunduar me hartimin e ADGJSH, i cili ka edhe kufizimet e veta që janë vënë në dukje nga kritika shkencore. Veç të tjerash, Atlasi nuk i kushton vëmendjen e duhur sintaksës dialektore, edhe për arsye të mangësive në studimet sistematike sintaksore në kohën e hartimit të tij. Sot kjo zbrazëti synohet të plotësohet me zhvillimin e një projekti për *variacionin sintaksor në të folmet e shqipes*. Hulumtimi i dialekteve dhe kërkimi në terren është një nevojë e domosdoshme dhe bazë për studime të thelluara të gjuhësisë historike dhe të gjuhësisë së sotme. Vitet e fundit janë organizuar dy konferenca mbi *variacionin sintaksor në të folmet e shqipes*.

Në rrafshin sinkronik vëmendja kryesore e trajtimit shkencor në gjuhësi është drejtuar në ***studimin e sistemit të gjuhës shqipe***, me përqendrim në çështjet të fonetikës, gramatikës e të leksikut të shqipes së sotme.

Studimet në fushë të fonetikës shqipe kanë sjellë rezultate të qëndrueshme, sidomos *për fonetikën e fonologjinë e shqipes standarde* (nga A. Dodi, B. Beci, R. Ismajli, L. Boriçi, I. Sawicka, A. Jubani). Për *sistemin fonetik të të folmeve veriperëndimore dhe sistemin fonetik të së folmes së Shkodrës* me rëndësi është punimi i B. Becit, që zbaton metodën strukturaliste në analizën e materialit fonetik të regjistruar me metoda eksperimentale laboratorike. Për *theksin në gjuhën shqipe* duhet përmendur studimi eksperimental i Halit Halimit mbi parametrat akustikë të theksit në shqipe (botim frëngjisht, ASHAK 2010). Një studim monografik i viteve të fundit në një fushë pak të studiuar të fonetikës është *Struktura e rrokjes në shqipe* nga Irena Sawicka e Karolina Dargiel (ASHAK, 2018).

Në fushën e gramatikës shqipe në gjysmën e dytë të shek. XX u angazhuan specialistët më të mirë të kësaj fushe, si Sh. Demiraj, M. Domi, S. Floqi, F. Agalliu, R. Përnaska, E. Likaj, A. Dhrimo, M. Totoni, M. Çeliku etj., të cilët analizuan në studime të posaçme e në vepra monografike kategori e tema të veçanta të morfologjisë e sintaksës dhe ndërmorën edhe vështrime përgjithësuese e trajtime problemore të këtyre temave. Këto studime ishin edhe në funksion të projektit të Institutit të Gjuhësisë për një *Gramatikë të gjuhës së sotme shqipe* (1976, 1997, 2002), e cila tashmë është afirmuar si një pikënisje dhe referencë e domosdoshme për çdo studim që ndërmerret në këtë fushë. Një vepër tjetër e rëndësishme për sistemin gramatikor të shqipes është *Gramatika e shqipes (Albanische Grammatik)* e W. Fiedler dhe Oda Buchholz (Berlin 1987) në të cilën sistemi gramatikor i shqipes së sotme vështrohet në të gjitha rrafshet e tij dhe ku përfshihen edhe analiza të qasjeve teorike të ndryshme nga gramatologjia tradicionale e shekullit XX siç janë analizat funksionale e strukturore si dhe këndvështrime të gramatikës gjenerative. Nga gramatikat universitare duhet përmendur ajo e M. Camajt. Në fushën e morfologjisë së emrit në shqipe një studim shterues përbën vepra monumentale e W. Fiedlerit *mbi formimin e shumësit në gjuhën shqipe* (ASHAK, Prishtinë 2007). Fjalëformimi, ndonëse është parë si një fushë studimore e ndërmjetme, midis morfologjisë e leksikologjisë, është trajtuar teorikisht në gramatikë. Kontribut të veçantë në konsolidimin e kësaj disipline kanë dhënë A. Xhuvan i & E Çabej (1956, 1962), A. Kostallari (1962), K. Cipo (1949), E. Lafe (*Gramatika* 1997, pjesa teorike mbi fjalëformimin), ndjekur më pas nga studiues më të rinj, me vepra të nivelit monografik, si E. Hysa (2004), L. Buxheli (2008, 2009), A. Dhrimo (2017) etj. Studimeve mbi rendin dhe sistemin gjuhësor u takojnë gjithashtu punimet shkencore të E. Pacit.

Vitet e fundit studiuesit e gramatikës së shqipes së sotme kanë sjellë **koncepte më të reja sintaksore bashkëkohore të gramatikës gjenerative e të gramatikës së konstrukcionit** (G. Turano, 1995). Nuk kanë munguar edhe *sintaksat e shqipes me këndvështrim të ri teorik, kryesisht gjenerativist* (J. Mita 2005, F. Koleci-G. Turano 2011, M. Çeliku 2012). Të nivelit bashkëkohor janë edhe punimet e kryera kohët e fundit dhe projektet e ndërmarra në universitete të huaja me fokus gjuhën shqipe në fushën e gjuhësisë së zbatuar. Prirja e gramatikanëve drejt qasjeve teorike

bashkëkohore buron jo vetëm nga kërkesat për përsosjen e metodologjisë dhe ngritjen e nivelit teorik të studimeve shkencore në fushën e gramatikës, por edhe nga *nevoja e hartimit të një gramatike të re shkencore, me qasje krejtësisht deskriptive*.

Në fushën e gramatikës shqipe janë zhvilluar disa konferenca shkencore në vitet e fundit, si: konferenca shkencore kushtuar Spiro Floqit (IGJL - QSA, 2013); konferenca ndërkombëtare *Pikësimi në gjuhën shqipe* (IGJL - ASA 2018), si dhe vargu i konferencave të përvitshme *Kërkime gjuhësore*, organizuar nga IGJL (2012-2019) ku janë trajtuar edhe tema nga fusha e gramatikës e sintaksës shqipe etj.

Në fushën e leksikologjisë dhe leksikografisë janë realizuar gjithashtu studime të rëndësishme dhe vepra themelore leksikografike, sidomos nga gjuhëtarët shqiptarë. Ndër çështjet më të trajtuara në fushën e leksikologjisë sinkronike janë ato që i kushtohen fjalës shqipe si njësi leksikore, lidhjeve kuptimore të fjalëve, frazeologjisë së gjuhës shqipe, shtresimit të leksikut të sotëm etj. ku dallohen punimet e Jani Thomait për probleme teorike, të patrajtuara më parë ose shumë pak të trajtuara, kushtuar sidomos frazeologjisë së gjuhës shqipe dhe çështjeve që lidhen me të, si dhe çështje të semantikës leksikore që lidhen me përshkrimin e tipareve themelore të derivacionit semantik në leksikun e sotëm të shqipes, fushë kjo pothuajse e parrahur në shqipe më parë. Studimet në këto fusha janë përfshirë në dy vepra themelore të këtij studiuesi: *Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe* (1989, 2009), *Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe* (1999, 2010), si dhe në veprën krahasuese nga fusha e gjuhësisë ballkanike *Fjalor frazeologjik ballkanik* (1999). Studimet e veçanta për vlerat kuptimore të fjalëve, përkatësisht homonimet, antonimet e sinonimet etj., dhe lidhjet e tyre sistemore sollën botimin e veprave të mëdha si *Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe* (J. Thomai, M. Samara, H. Shehu, Th. Feka, 2005), *Fjalor i antonimeve në gjuhën shqipe* (M. Samara 1998). Për studimin e sinonimisë e të vargjeve sinonimike në gjuhën shqipe ka ndihmesa me vlerë edhe Sh. Islamaj, dhe për studimin e homonimeve Xh. Lloshi. Me interes janë studimet e Xh. Lloshit për veçoritë stilistike të shqipes etj.

Studimet nga fusha e leksikut lidhen ngushtë dhe kushtëzojnë edhe zhvillimin e leksikografisë, ku ka mjaft arritje në fushën e hartimit të fjalorëve një- dhe dygjuhësh. Vepra madhore *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe* (1980), rezultat i një pune të ngjeshur kolektive nën drejtimin e A. Kostallarit, e mbështetur në një bazë të gjerë materiale si *Kartoteka e leksikut të shqipes* me rreth 5 milion skeda, është ndjekur nga disa fjalorë të tjerë të tipeve të ndryshme (1984, 2002, 2006) dhe së shpejti pritet të dalë edhe një fjalor i vogël me 35 mijë fjalë si botim për nevoja shkollore (J. Thomai, V. Memisha, H. Shehu, Th. Feka, M. Samara, P. Haxhillazi). U miratua së fundi nga Akademia e Shkencave edhe *projekti i një fjalori të tipit të madh*, me rreth 100 mijë fjalë, një vepër e planifikuar dhe e nisur që në vitet 1980 dhe e mbetur si dëshirë e porealizuar për vite me radhë. Bazat teorike për hartimin e fjalorëve të tipave të ndryshëm janë vendosur në punën studimore paraprake që është kryer në përputhje me nevojat e hartimit të këtyre fjalorëve,

si p.sh. fjalori shpjegues dhe ai normativ i shqipes së sotme, fjalorët dygjuhësh, fjalorët krahinorë etj. nga A. Kostallari dhe J. Thomai, duke përcaktuar kriteret e hartimit të fjalorëve, veçanërisht normativë, si dhe të mënyrës së pasqyrimin të kuptimeve dhe të përdorimeve të fjalëve në fjalorin shpjegues. Një numër i madh fjalorësh dygjuhësh është botuar nga studiues e përkthyes të apasionuar. Janë hartuar gjithashtu një numër fjalorësh terminologjikë (H. Pasho, A. Duro etj.) në bashkëpunim me specialistë të fushave të ndryshme. Leksikografisë shqipe i janë kushtuar dy konferenca shkencore: nga ASH e Shqipërisë: *Leksikografia shqipe - trashëgimi e perspektivë* (2004) me botimin e akteve përkatëse (2005); si dhe nga ASHAK në bashkëpunim me IGJL, konferenca shkencore ndërkombëtare *Studime për fjalën shqipe dhe leksikografia dialektore e shqipes*, Prishtinë 2019. Për terminologjinë është organizuar një konferencë shkencore ndërkombëtare nga Akademia e Shkencave dhe IGJL: *Gjendja dhe zhvillimi i terminologjisë shqipe* (2009).

Mbas kodifikimit të standardit të shqipes, në studimet gjuhësore pati edhe trajtesa kushtuar çështjeve të studimit të gjuhës letrare, si varianti më i lartë gjuhësor, të strukturës së saj funksionale dhe të politikës gjuhësore. Disa nga problematikat kryesore që janë trajtuar në këtë fushë janë ecuria dhe nevoja e përvetësimit dhe ngulitjes së këtij varianti të shqipes së sotme, nevoja e përcaktimit të drejttimeve dhe të përsosjes së sistemit e të strukturës së gjuhës së sotme letrare, në planin leksikor e gramatikor (fonetik, morfologjik, leksikor e sintaksor). Çështje të rëndësishme janë ato kushtuar bazës dialektore të standardit dhe problemit të purizmit. Pjesë e diskutimit për karakterin shkencor të normësimit të shqipes u bënë dhe albanologët e huaj (J. Byron, *Selection between alternatives on the standardization of language: the case of Albanian*). Problemi i ngulitjes së gjuhës letrare shqipe trajtohej i lidhur ngushtë me problemet e ngritjes nivelit të kulturës gjuhësore. Theksi vihej sidomos në pastërtinë e gjuhës dhe mënjanimit të fjalëve të huaja të panevojshme. Në periudhën që pasoi ndryshimin demokratik të sistemit në Shqipëri, edhe çështja e gjuhës së njësuar letrare, si një çështje e lidhur me politikën gjuhësore shtetërore, u rihodh në diskutim me synimin për të rishikuar bazën dialektore të standardit, që konsiderohej njëdialektore, dhe për të përfshirë elemente të dialektit verior të shqipes, të mbetur në nivelin e një varianti substandard. Për këtë qëllim u organizua edhe një konferencë gjuhësore në vitin 2010 ku u shprehën mendime të ndryshme lidhur me zgjerimin e kufijve të standardit për ta bërë më “gjithëpërfshirës”, përkatësisht për rishikimin e drejtshkrimit të shqipes në shumë pjesë të sistemit të tij. Këto propozime nuk gjetën miratim të gjerë në masën e përdoruesve të shqipes dhe nuk u miratuan në një forum vendimmarrës. Ndërkohë standardi i shqipes ka vazhduar të funksionojë e të zhvillohet si çdo variant gjuhësor, me gjithë goditjet që pëson nga një rënie e përhapur e kulturës gjuhësore në mbarë hapësirën shqipfolëse në Ballkan dhe nga trysnia e globalizimit të shoqërisë. Problematikat e gjuhës letrare janë trajtuar në botime të shumta, ku përmendim studiuesit M. Çeliku (2009), A.

Çerpja (2015), I. Bajçinca (2016), R. Memushaj (2002-2018); si dhe në konferenca kushtuar gjuhës letrare shqipe, si: konferenca shkencore *Gjuha letrare kombëtare dhe bota shqiptare sot* (1992); konferenca shkencore ndërkombëtare *Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot* (2002).

Për mirëmbajtjen e gjuhës standarde as në Shqipëri as në Kosovë nuk ka një instancë të posaçme për t'u kujdesur për rritjen e ndërgjegjësimit të përdoruesve për gjuhën standarde dhe për përdorimin korrekt të gjuhës dhe drejtshkrimit të saj. Një hap institucional në këtë drejtim u krye në Maqedoninë e Veriut, me krijimin e Agjencisë për Zbatimin të Ligjit për përdorimin e Gjuhës shqipe dhe ngritjen e Inspektoriatit Gjuhësor, që kanë si synim para së gjithash vëmendjen ndaj gjuhës standarde shqipe. Një ndihmë efektive për përdoruesit e gjuhës standarde do të ishte *ribotimi i fjalorit drejtshkrimor*, me përmirësimet e nevojshme mbas një rishikimi të studiuar në përputhje me kërkesat e kohës; si dhe *i akteve vendimore të Këshillit Ndërakademik për Gjuhën Shqipe*.

Në vitet e fundit janë hedhur hapa në drejtim të studimit të të ashtuquajturave *shkenca të ligjërimit*, pra studimi i dukurive, proceseve, veçantive e prirjeve të funksionit të shqipes në etapën e tanishme. Këto çështje kanë të bëjnë me atë që quhet *gjuhësi e jashtme*, e cila parakupton studimin e gjuhës në lidhje me faktet historike, politike, ekonomike, fetare, letrare dhe gjeografike të kohës, ndryshe nga *gjuhësia e brendshme*, e cila merret me studimin e gjuhës në vetvete dhe për vetveten. Ndërkohë, studimet në fushën e stilistikës e pragmatikës të Xh. Lloshit, por edhe ato në fushën e *gjuhësisë së tekstit*, sidomos të tekstit letrar, *gjuhësisë së diskursit* etj. nga studiues të ndryshëm në Shqipëri, Kosovë e Maqedoninë e Veriut kanë nxitur ecjen edhe nëpër këto hulli (J. Thomaj, R. Ismajli, T. Topalli, T. Plangarica, B. Rugova etj.). Koha e kërkon që të nxiten edhe më shumë interesimet edhe në këtë fushë, pavarësisht nga vështirësitë. Shqyrtimi i dukurive gjuhësore edhe përmes kësaj qasjeje, do të mundësojë kontribute të mendimit tonë gjuhësor edhe në *gjuhësinë teorike*, a më gjerë, në *gjuhësinë e përgjithshme*, ku shqipja ka jo pak mundësi për prurje me vlerë.

Në kohën e sotme është e nevojshme të nxitet diskutimi në lidhje me vendin më të gjerë që duhet të zënë dijet dhe shqyrtimet empirike të bëra në kuadër të *gjuhësisë së zbatuar*. Është e nevojshme të zgjerohen hapësirat e studimit të kësaj disipline a fushe shqyrtimi që është e lidhur jo vetëm me praktikën e mësimdhënies e të nxënies, me didaktikën e gjuhës, por edhe me çështjet e neurolinguistikës, me “gjuhët” sociale e profesionale, me gjuhët e pakicave, me trajtimin automatik të gjuhëve, me rolin e gjuhës/ligjërimit në raportet ndërpersonale etj. Prurjet e kësaj fushe studimi do të mundësojnë më tej edhe përfitim të *gramatikës shkollore*, të *gramatikave të diskursit e tekstit* etj., tejet të nevojshme për mësimdhënien e shqipes në shkollë.

Për të bërë të njohur për publikun dhe aktorët vendimmarrës të mësimdhënies në Shqipëri nevojën e njohjes së arritjeve të shkencave të ligjërimit dhe zbatimit të

tyre në arsim për një metodë më efikase të mësimshënies, IGJL ndërmoi një konferencë shkencore me temë *Zhvillimet në shkencat e ligjërimit dhe lënda e gjuhës dhe e letërsisë në arsimin parauniversitar* (2019).

I.F. Zhvillimi i studimeve letrare

Letërsia shqipe e fitoi përmasën europiane dhe u ndërkombëtarizua në periudhën e humanizmit, me veprën e M. Barletit. Zhvillimet e mëvonshme në shumicën e kohës qenë të vonuara dhe jo në sinharmoni me zhvillimet europiane. Në shekullin e modernitetit, që pasoi Rilindjen kombëtare, u krijuan dhe u shpërfaqën disa korrelacione të qarta midis shkrimtarëve shqiptarë dhe atyre evropianë: Jeronim de Rada dhe Lamartin e F. Mistral, F. Konica dhe G. Apollinaire, Fan Noli dhe Bernard Shaw, L. Poradeci dhe Ch. Baudelaire, Migjeni dhe F. Nietzsche. Disa lidhje u ruajtën edhe më vonë: Petro Marko dhe E. Hemingway, M. Camaj dhe E. Montale. Një traditë përkthimesh në kuadër të marrëveshjeve me *vendet e demokracive popullore* promovoi një letërsi mesatare në këto vende. Promovimi i letërsisë shqipe të Kosovës në republikat e ish-Jugosllavisë ishte gjithaq në funksione joletrare. Problemi i raporteve me letërsinë europiane u bë më i mprehtë në dekadat e fundme. *A e ka rifituar përmasën e vet ndërkombëtare europiane letërsia shqipe*, si letërsi që përfshihet në enciklopeditë, fjalorët, historitë e letërsive dhe tekstet e programet universitare, me përkthimin e letërsisë së I. Kadaresë dhe njohjen e saj përmes disa çmimeve konfirmuese botërore? Apo letërsia shqipe, një shekull pas themelimit të Shqipërisë shtetërore, mbetet ende *një letërsi provinciale, në mënjani të megasistemeve letrarë*? Në kushtet e shoqërive të hapura, në kushtet e kalimit prej ishujve letrarë në *megasisteme letrare*, sipas termit të studiuesit Itamar Even-Zohar, kjo pyetje është e pashmangshme. Mirëpo përgjigja e saj varet jo vetëm nga *dinjteti i letërsisë vetë*, por edhe nga shumë faktorë të tjerë: *cila është tradita e përkthimit në gjuhën e tjetrit; cilat janë gjuhët dhe letërsitë e interesuara për të për shkaqe gjenetike dhe historike; cilët janë të huajt që e përkthejnë letërsinë shqipe dhe çfarë inkurajimesh u ofrohen atyre; cilat janë historitë e letërsisë në botë që bëhen të vëmendshme ndaj saj, cilët janë universitetet dhe shkencëtarët që e studiojnë atë*.

Studimet letrare u bënë pjesë e kërkimit shkencor në fushën e albanologjisë relativisht vonë. Studimet në këtë fushë kanë synuar të hedhin dritë në procesin e formimit të letërsisë kombëtare të shqiptarëve, në veçoritë e këtij procesi vështruar edhe në rrafsh krahasimtar, si dhe në njohjen dhe analizimin e krijimtarisë së shkrimtarëve shqiptarë të gjithë periudhave letrare. Në fushën e studimeve letrare detyrë themelore janë studimet për zhvillimin historik të letërsisë shqipe, për jetën dhe veprën e përfaqësuesve të saj më të shquar, hartimi i veprave përgjithësuese historiko-letrare si dhe botimi kritik shkencor i klasikëve të traditës letrare. *Interesimi ndërkombëtar për letërsinë shqipe u shndërrua në shkencë kur vetë letërsia shqipe u bë letërsi europiane e botërore* dhe studimi i saj hyri në programet shkollorë-universitare, në leksikonët dhe enciklopeditë tematike. Kjo

arritje lidhet me emrin e Ismail Kadaresë, i vetmi autor shqiptar që studiohet në historinë e letërsisë europiane dhe atë botërore. Përveç Kadaresë, në raste të pjesshme studiohen, për qëllime krahasuese dhe si pjesë e një historie letërsie ballkanike, edhe Jeronim de Rada (*orientimi perëndimor i letërsisë shqipe*); Naim Frashëri (*lidhjet historiko-letrare shqiptaro-perse*); Faik Konica (*lidhjet historiko-letrare shqiptaro-frënge*); Migjeni (*lidhjet historiko-kulturore shqiptaro-ballkanike dhe shqiptaro-perëndimore*); Fan Noli, Lasgush Poradeci (*ndikimet e simbolizmit frëng*), Petro Marko (*dhe ngjashmëritë me "brezin e humbur"*), Luan Starova (*shkrimtari i tri letërsive*).

Studimeve letrare u janë kushtuar disa konferenca në vitet e fundit, si: konferenca shkencore *Letërsia si e tillë* (1996); konferenca shkencore *Polemikat letrare* (2015); vargu i konferencave të përvitshme *Studime letrare në proces: teza, projekte, ide dhe rezultate I-IV* (2015-2018) me pjesëmarrës nga Shqipëria dhe Kosova; konferenca shkencore kombëtare *Zhvillime gjuhësore dhe letrare në periudhën e Pavarësisë*, organizuar nga Universiteti *Eqrem Çabej* (2018); konferencat shkencore për figura të shquara kombëtare në fushën e letërsisë, si ato kushtuar Faik Konicës (1992); Migjenit (1998, 2010); Naim Frashërit (2000, 2018); Zef Serembes (2001), Ernest Koliqit (2003); Jeronim de Radës (2003, 2016), Petro Markos (2012); Lef Nosit (2012); Fan Nolit (2014); Dritëro Agollit (2016); Rexhep Qosjes (2017); Mitrush Kutelit (2018); Lasgush Poradecit (2019) etj.

Një konferencë shkencore ndërkombëtare, me pjesëmarrjen e mbi 20 studiuesve dhe përkthyesve të huaj, u organizua nga Akademia e Shkencave më 2016, kushtuar 80-vjetorit të lindjes së shkrimtarit I. Kadare.

Disa konstatime për studimet letrare në shekullin XXI:

1. Letërsia shqipe e fitoi përmasën europiane në shekujt e humanizmit europian, me M. Barletin, dhe e rifitoi atë në kohët modern, me I. Kadarenë;
2. Zhvillimet sinkronike dhe simetrike të letërsisë shqipe me atë europiane kanë qenë të kufizuara (periudha e humanizmit, shekulli i Voskopojës, koha moderne);
3. Promovimi i letërsisë shqipe në botë përmes antologjive nisi shumë vonë dhe në një pjesë të rasteve (gjatë gjysmës së parë të shek. XX) u bë për shkak të politikave të përbashkëta dhe marrëveshjeve kulturore me vende të tjera;
4. Roli dhënës i letërsisë shqipe në botë në rrjedhë të shekujve ka qenë modest, deri në gjysmën e dytë të shekullit XX, kur kjo letërsi u nderua me çmime të rendit parësor europianë e botërorë dhe u bë pjesë e programeve universitare;
5. Paraqitja e vendit të letërsisë shqipe në botimet enciklopedike europiane dhe botërore është shtuar, por ende shpesh është rastësor dhe i vonuar;
6. Rruga e hapur nga J. Vrioni, për një shkollë përkthyesish nga shqipja në gjuhë të huaj, nuk u ndoq. *Letërsia shqipe përkthehet nga të huajt shqipfolës*;
7. Politikat shtetërore në Shqipëri dhe në Kosovë nuk kanë ofruar nxitje e mbështetje për krijimin e një shkolle shqiptare përkthyesish në gjuhë të huaj;

9. Nderimi më i lartë ndërkombëtar që ka merituar letërsia shqipe deri më sot është *Njeriu Ndërkombëtar i Librit* (2006). *Letërsia shqipe është e vetmja letërsi në Ballkan që ende nuk ka arritur të fitojë një herë çmimin "Nobel"*;
10. Letërsia shqipe, duke qenë letërsi etnografike në pjesën e saj më të madhe, ka mundësuar promovimin e identitetit dhe të etnotipit shqiptar në botë;
11. Autori më i studiuar në albanologjinë e sotme në botë, pas Mesharit të Gjon Buzukut (W. Fiedler, J. Matzinger), është Ismail Kadare, me një shkollë studimesh albanologjike me përhapje nga Europa në Rusi e Kinë, në SHBA e Australi;
12. Veprat më të përkthyer, veç letërsisë së Ismail Kadesë, rezultojnë ato që lidhen me jetën tradicionale shqiptare dhe trashëgiminë gojore shqiptare: eposi heroik legjendar, *Kanuni i Lekë Dukagjinit* dhe *Lahuta e Malcës*;
13. Letërsia shqipe, më shumë për shkak të moskomunikimit dhe të promovimit të padenjë, se për shkak të kufizimeve të saj, mbetet ende me disa ura të ngushta lidhjeje me letërsinë europiane dhe më e papërkthyer në Ballkan;
14. Që nga viti 1974 e në vijim shkrimtari I. Kadare është kandidaturë konkurruese për çmimin Nobel, disa herë i nominuar në përzgjedhjen përfundimtare.

I.G. Studime në fushën e historisë

Në fushën e historisë, botimi i burimeve historike, tregimtare e arkivore për historinë e Shqipërisë, u caktua si një detyrë prioritare për institucionet shkencore. Mbi bazën e lëndës arkivore e bibliografike të botuar apo të mbledhur së rishmi nga arkivat e huaja, duke filluar nga viti 1960, në mënyrë sistematike, u botua një numër i madh vëllimesh dokumentare për periudhën antike, për mesjetën bizantine e romane, për periudhën osmane (shek. XVI-XIX), për Lidhjen e Prizrenit, për periudhën nga Pavarësia te Konferenca e Paqes 1919 e deri për Luftën II Botërore. Botimi i tyre ishte frut i një pune të palodhur të studiuesve I. Zamputi, A. Buda, P. Pepo, H. Ceka, S. Islami, F. Prendi, S. Pulaha, K. Frashëri, K. Bozhori, Z. Shkodra, S. Naço, L. Malltezi, K. Prifti, F. Duka, P. Xhufi etj. Për përkthimin nga osmanishtja të defterëve e të akteve zyrtare të Portës së Lartë dhanë një kontribut të çmuar Myqerem Janina e Vexhi Buharaja. Fonde dokumentare për mesjetën e kohën e re u tërhoqën nga arkivat e Venedikut, Raguzës, Vjenës, Stambollit, Romës, Kajros, Parisit, Londrës etj.

Kjo fazë akumuluese u pasua nga një veprimtari e gjerë studimore e botuese në fushën e historiografisë. Veçohen si vepra-sintezë të mendimit shkencor botimet akademike *Historia e Shqipërisë*, vëll. I (1959) me autor S. Islami e Kristo Frashëri; *Histoire de l'Albanie* botuar në Francë (1974) me autor S. Pollo, A. Puto, S. Anamali e K. Frashëri; *Histori e Shqipërisë* në 3 vëll. (1984); *Histori e popullit shqiptar*, në 4 vëllime (2002). U botuan ndërkohë edhe studime monografike nga fusha të ndryshme të historisë. Për periudhën e Mesjetës botuan: S. Pulaha, *Shqiptarët dhe trojet e tyre* (1982), *Qytetet shqiptare në Kosovë në shek. XVI* (1984),

Popullsia shqiptare e Kosovës shek. XV-XVI (1984), Pronësia feudale në tokat shqiptare, shek. XV-XVI (1988); L. Malltezi, Qytetet shqiptare gjatë pushtimit venedikas (1988); P. Huta, Fshati në sanxhakun e Shkodrës shek. XV-XVI (1990); K. Frashëri, Skënderbeu, jeta dhe vepra (2002), Principata e Arbërisë (2014); P. Xhufi, Dilemat e Arbërit (2006), Nga Paleologët te Muzakajt (2008), Shekulli i Voskopojës (2010), Àrbrit e Jonit: Vlora, Delvina e Janina shek. XV-XVII (2017), Skënderbeu, ideja dhe ndërtimi i shtetit (2019); E. Malaj, Drishti, historia dhe fizionomia e një qyteti mesjetar shqiptar (2016); P. Bogdani, Balshajt (2018); F. Duka, Berati në kohën osmane, shek. XVI-XVIII (2001), Shekujt osmanë në hapësirën shqiptare (2010).

Për periudhën e sundimit osman, të Lëvizjes Kombëtare e të krijimit të shtetit të pavarur shqiptar, kanë botuar: S. Naçi, *Pashallëku i Shkodrës nën sundimin e Bushatllinjve* (1964); I. Koçollari, *Policia sekrete e Ali Pashës*, 2 vëll. (2008), *Krokodil Klada, kryengritës i dy popujve* (2009), *Emigrimet shqiptare në mesjetë: Arvanitët* (2011), *Ali Pasha dhe Shqipëria në arkivat britanike* (2013); Z. Shkodra, *Shqipëria në kohën e Tanzimatit* (1959), *Esnafet shqiptare, shek. XV-XX* (1973), *Qyteti shqiptar gjatë Rilindjes Kombëtare* (1984); K. Frashëri, *Abdyl Frashëri* (1984), *Lidhja Shqiptare e Prizrenit* (1997); K. Prifti *Lidhja shqiptare e Pejës* (1984), *Dervish Hima* (1987), *Ibrahim Temo, jeta dhe vepra* (1993), *Popullsia e Kosovës* (2014); A. Puto, *Pavarësia shqiptare dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha* (1978), *Shqipëria politike 1912-1939* (2009); R. Gurakuçi, *Shqipëria 1911-1914* (2012); G. Shpuza, *Gjurmime në epokën e Rilindjes Kombëtare* (1980), *Kryengritja fshatare e Shqipërisë së mesme, 1914-1915* (1986), *Aspekte të mendimit politik shoqëror shqiptar 1913-1915* (1990); M. Çami, *Lufta çlirimtare antiimperialiste e popullit shqiptar 1918-1920* (1969), *Kongresi i Lushnjës. Lufta e Vlorës* (1974), *Çështje të lëvizjes demokratike dhe revolucionare shqiptare në vitet 1921-1924* (1977), *Shqipëria në marrëdhëniet ndërkombëtare 1914-1918* (1987), *Shqipëria në Konferencën e Paqes 1919-1920*.

Në këto dekada të fundit ka prurje të rëndësishme edhe nga historiografia e huaj. Peter Bartl, përveç botimit të dokumenteve të Vatikanit për Shqipërinë e shek. XVII-XIX në serinë *Albania Sacra*, ku deri tani kanë parë dritën e shtypit 4 vëllime, ka botuar monografinë *Ballkani Perëndimor midis monarkisë spanjolle dhe perandorisë osmane, shek. XVI-XVII*, me shumë të dhëna për lëvizjet kryengritëse shqiptare dhe lidhjet e tyre me mbretërinë spanjolle (1974). Alain Ducellier ka botuar një vepër themelore e të shumëdokumentuar për mesjetën shqiptare, *Fasada bregdetare e Shqipërisë në Mesjetë. Durrësi e Vlora në shek. XI-XV* (1981). Lucia Nadin zbuloi në dorëshkrim dhe botoi: *Statutet e Shkodrës* (2002), vepër themelore mbi organizimin e një qyteti mesjetar shqiptar; *Migrim e integrim: rasti i shqiptarëve në Venedik, 1479-1552* (2008); *Shqipëria e rigjetur* (2012) dhe *Figura e Skënderbeut në jetën kulturore dhe artistike të Venedikut* (2018). Autori me origjinë arbëreshe Paolo Petta ka botuar dy monografi mjaft të vlerësuara: *Stratitët: ushtarë shqiptarë në Itali shek. XV-XIX* (1996) dhe *Despotë të Epirit e princë të Maqedonisë* (2000). Studiuesi i mirënjohur anglez Noel Malcolm, pas librit të tij me jehonë të jashtëzakonshme ndërkombëtare *Kosova, një histori e shkurtër* (1998), botoi një monografi mbi familjen shqiptare Bruni nga Ulqini, *Ajentë perandorakë: një familje shqiptare në botën mesdhetare të shek. XVI* (2015)

dhe së fundi *Kryengritës, mbijetues: studime në historinë e Shqiptarëve* (2020). Oliver Jens Schmitt ka botuar *Arbëria Veneciane, 1392-1479* (2001) dhe *Skënderbeu* 2008, vepër që ngjalli polemika të forta mes historianëve shqiptarë e të huaj. Një botim që i mungonte historiografisë, pavarësisht momenteve të debatueshme të tij, ishte ai i Nathalie Clayer, *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar* (2008).

Përpos arritjeve të pamohueshme, studimet albanologjike, në mënyrë të veçantë ato në fushën e historisë, e ndjenë presionin e skemave ideologjike të mendimit marksist-leninist mbi luftën e klasave, mbi rolin e masave e të individit, mbi rolin e fesë, mbi vendin e Shqipërisë në marrëdhëniet Lindje-Perëndim, ku ky i fundit duhej parë vetëm si burim luftërash e pushtimesh. Skemat e imponuara ideologjike dëmtuan vërtetësinë historike e trajtimin shkencor, sidomos për sa i përket studimit të ngjarjeve, proceseve e personaliteteve historike të kohëve më të reja. Pavarësisht nga kjo, krijimi i një shkolle linguistike, historiografike, arkeologjike e antropologjike të specializuar në studimet shqiptare ishte një sukses i madh, që nuk vonoi të japë frytet e veta. Në bashkëpunim mes degëve të albanologjisë e me një qasje metodike ndërdisiplinore, institucionet shkencore e personalitete të shquara shkencore shqiptare, mbi bazën e kriterëve rigorozisht shkencore e duke vlerësuar në mënyrë kritike edhe arritjet e albanologëve të huaj, arritën të identifikojnë, të sjellin prova bindëse dhe të tentojnë zgjidhjen e dilemave thelbësore të historisë së popullit shqiptar, siç janë: ***a kanë qenë ilirët në periudhën historike një popull autokton, apo i ardhur nga shtretër të tjerë historikë; a janë shqiptarët, me gjuhën e kulturën e tyre, një vijim gjenetik i ilirëve, i gjuhës e kulturës së tyre; a kanë mundur iliro-shqiptarët të krijojnë, në marrëdhënie e shkëmbime me të tjerët, një qytetërim të vetin origjinal, e cilat do të ishin tiparet themelore të tij; a ka patur, e nëse po, cila ka qenë ecuria e autonomive lokale dhe e organizimit shtetëror tek shqiptarët, nga mesjeta e hershme deri në dekadat e fundit të sundimit osman; cili ka qenë vendi e roli i shqiptarëve në zhvillimet politike, në dukuritë ekonomike, sociale, kulturore e demografike të arealit ballkanik e mesdhetar.***

Studimet e thelluara në fushën e historisë, gjuhësisë e të arkeologjisë në qendrat e njohura albanologjike, brenda e jashtë Shqipërisë, u kanë dhënë përgjigje pohuese pyetjeve të tilla. ***Një prurje e madhe në këto fusha ka ardhur pas vitit 1999 nga institucionet e studiuesit e Kosovës.*** Në kushtet e lirisë e të mëvetësisë shtetërore, në Kosovë u intensifikuan studimet mbi historinë, onomastikën mesjetare e gjuhësinë historike, dhe u kryen në shkallë të gjerë kërkime arkeologjike, duke nxjerrë në pah monumente të shumta të kulturës ilire, të krishtëritimit të hershëm dhe të mesjetës së hershme. Këto arritje integrohen me rezultatet e arritura në Shqipëridhe plotësojnë kuadrin e kulturës ilire e të kulturës iliro-arbërore të Komanit në një areal gjeografik më të shtrirë, se ai i mëparshmi.

Në studimet historiografike, për vështirësi objektive, por dhe për mungesë vizioni e orientimi, *janë lënë pas dore prioritetet e dikurshme.* Kanë shkuar duke u venitur e

rrezikojnë të shuhen studimet institucionale për periudhën e Mesjetës së hershme e atë bizantine, bazike në kuadrin e studimeve për vazhdimësinë iliro-shqiptare dhe për qytetërimin mesjetar shqiptar. Me largimin e specialistëve të gjuhës osmane, ka mbetur pa u mbuluar periudha e gjatë historike e sundimit osman. Zbrazëtia në këtë drejtim bëhet më e rëndë nga fakti se departamenti i dikurshëm i Rilindjes Kombëtare, dikur një nga departamentet kryesorë, nuk ekziston më. Sot për Rilindjen Kombëtare po zhvillohen debate të forta *mbi periodizimin e mbi shfaqje më të hershme të kësaj lëvizje të madhe kulturore e politike, në Shqipëri e mes arbëreshëve të Italisë*. Në një debat të tillë, pjesëmarrja institucionale ka munguar, ndryshe prej njësive shkencore të gjuhësisë. ***Përparësia që u është dhënë periudhave më të reja, që nuk janë bërë ende pjesë as e shkencës së historisë dhe ca më pak e asaj të albanologjisë, ka dëmtuar***. Në të kundërtën, në këto dekada i është dhënë rëndësi trajtimit të temave nga historia bashkëkohore, duke i përfshirë studiuesit e rinj në projekte që nuk kanë të bëjnë me tematikën e mirëfilltë të shkencave kombëtare. Gamën e varfër të botimeve, në numër e në tematikë, fiktivisht e ka plotësuar dërgimi në shtyp i materialeve të gatshme që ruheshin në dorëshkrim në arkivat shkencorë që prej gjysmë shekulli (fonde dokumentare nga Arkivi i Vjenës, Venedikut, Raguzës si dhe defterë osmanë, të gjitha të përkthyer në gjuhën shqipe në pjesën më të madhe nga personalitete që nuk kishin të drejtë përdorimi publik të emrit të tyre; kujtime protagonistësh të ngjarjeve ende me dëshmitarë etj. Botimi kryesor në këtë fushë që nga viti 2007 e këtej mbetet *Historia e shqiptarëve gjatë shek. XX*, prej të cilit janë shtypur 2 vëllime. Bëhet fjalë për një projekt shumëvjeçar të financuar nga qeveria, për të cilin janë bërë ekspedita të shumta në arkivat e kryeqyteteve kryesore të botës. Projekti nisi nga një nxitje e politikës për “rishkrimin” e historisë bashkëkohore e në këtë funksion, për temat më të debatuar në opinionin e gjerë, u përzgjedhën autorë “politikisht korrektë”, por që edhe në këtë rast kanë treguar inkompetencë e mungesë integriteti profesional. Në këto kushte, ato arritje në fushën e studimeve e të botimeve, që gjithsesi s’kanë munguar, u detyrohen përpjekjeve individuale të studiuesve të veçantë. Nga ana tjetër, jeta shkencore në drejtim të tubimeve shkencore, kombëtare e ndërkombëtare ka shënuar mungesa për periudhën e Mesjetës romano-bizantine e osmane e gjithashtu të Rilindjes, ndërkohë që vitet e fundit janë zhvilluar disa veprimtari shkencore për ngjarje përkujtimore, si konferenca ndërkombëtare për 100-vjetorin e Pavarësisë (2012), konferenca shkencore Komiteti “Mbrotjtja kombëtare e Kosovës” dhe koha e tij (2018), konferenca shkencore *Skënderbeu dhe epoka e tij* (2018), konferenca shkencore *Aranitët në Librazhd* (2018), konferenca shkencore e organizuar në bashkëpunim edhe me Institutin e Historisë Ali Hadri (Prishtinë) *Shqiptarët dhe ndërkombëtarët në vitet 1912-1926* (2019), konferenca shkencore *Ismail Qemal Vlora dhe elita politike shqiptare në procesin e shtetndërtimit* (2019), konferenca shkencore treditore *Shqiptarët dhe koalicioni antifashist në Luftën e Dytë Botërore* (2019) etj.

Probleme të ngjashme, siç është ai i mungesës së specialistëve për tematika të veçanta (helenistë, bizantologë, latinistë, sllavistë, orientalistë), janë të pranishme në gjithë sistemin e kërkimit shkencor institucional. Në kërkimet gjuhësore ka zbrazëti në fusha të rëndësishme të studimit, si historia e gjuhës, fonetika eksperimentale, dialektologjia etj. Duhet theksuar dhe problemi i mungesës së një politike a të një ekonomie shkencore, të mirëkoordinuar e të mirorientuar, si domosdoshmëri për të ndërmarrë, në rrafsh ndërdisiplinor, aksione të rëndësishme shkencore për çështje kardinale të albanologjisë.

I.H. Kërkimet e studimet në fushën e arkeologjisë

Fillimet e arkeologjisë shqiptare si **dije vendëse** i detyrohen punës e pasionit të Hasan Cekës, i formuar në shkollën e Vjenës, specialist për historinë e arkeologjinë antikite e për numizmatikën. Në vitet 1930 N. Ceka bëri pjesë në grupin e arkeologëve francezë të drejtuar nga Léon Rey, që kreu gjermime në qytetin antik të Apolonisë, gjermime që ai i vazhdoi në mënyrë të pavarur edhe për 40 vite të tjera. Ceka mori pjesë gjithashtu në gjermimet arkeologjike në qytetin antik të Butrintit, nën drejtimin e arkeologëve italianë Luigi Ugolini e Domenico Mustilli. Dha kontribut të madh në realizimin e veprës kolektive *Ilirët dhe Iliria tek autorët antikë* (1965). Rezultatet e kërkimeve të tij shumëvjeçare në lëmin e arkeologjisë klasike Hasan Ceka i ka botuar në disa vëllime e punime shkencore (*Probleme të numizmatikës ilire* 1965; *Në kërkim të historisë ilire*, 1998 etj.).

Ashtu si në degët e tjera të albanologjisë vendëse, edhe arkeologjia shqiptare u strukturua si drejtim i mëvetshëm i kërkimit shkencor pas Luftës II Botërore. Veprimtaria e organizuar arkeologjike në Shqipëri filloi me krijimin e Muzeut Arkeologjik-Etnografik më 1948 dhe të sektorit të arkeologjisë në Institutin e Historisë dhe të Gjuhësisë të Universitetit të Tiranës më 1957, i kthyer në vitin 1976 në Qendër Kërkimore Arkeologjike, në përbërje të Akademisë së Shkencave. Në vitin 1965 u krijua edhe Instituti i Monumenteve të Kulturës në varësi të Ministrisë së Arsimit, me një sektor të posaçëm për vlerësimin e restaurimin e monumenteve të antikitetit e të mesjetës. Një numër specialistësh e studiuesisht të kualifikuar, si Hasan Ceka, Skënder Anamali, Frano Prendi, Aleksandra Mano, Selim Islami, Myzafer Korkuti, Hëna Spahiu, Zhaneta Andrea, Neritan Ceka, Damian Komata, Apollon Baçe, Aleksandër Meksi, Gjerak Karaiskaj, Sulejman Dashi e të tjerë arkeologë më të rinj, me gjermime sistematike në zonat e brendshme të vendit, nxorën në dritë një numër të madh vendbanimesh, kalash, ndërtimesh civile, objektesh kulti e nekropolesh ilire e arbërore, **duke dhënë kështu një lëndë të pasur e origjinale që hedh dritë mbi problematika qendrore të albanologjisë, siç është ajo e qytetërimit ilir e parailir, mbi marrëdhëniet e tij me qytetërimin grek e romak, mbi urbanizimin e qendrave ilire, mbi formimin e shteteve ilire, mbi proceset sociale e kulturore që u zhvilluan gjatë shekujve të sundimit romak e mbi lidhjet etno-kulturore të popullsive ilire me arbërit**. U zbuluan, vlerësuan e u

restauruan, gjithashtu, ndërtime të shumta me karakter ushtarak, civil e fetar të periudhës antike e mesjetare. Rezultatet e dala nga gërmimet arkeologjike, pasi iu nënshtruan studimeve të thelluara, **përforcuan tezën e vazhdimësisë iliro-shqiptare, deri atëherë të mbështetur kryesisht në të dhëna gjuhësore.**

Konferenca kombëtare për formimin e popullit shqiptar, të gjuhës e kulturës së tij, mbajtur në Tiranë më 1982, ishte një rast madhor ku **probleme të tilla kardinale të albanologjisë, siç është ai i vazhdimësisë iliro-arbërore dhe i gjenezës së popullit shqiptar u trajtuan në ballë të gjerë mbi bazën e konfrontimit të të dhënave historike, gjuhësore, arkeologjike e të antropologjisë.**

Kërkimet e studimet në fushën e arkeologjisë e kanë ruajtur ritmin dhe **në disa aspekte janë intensifikuar këto dekadat e fundit.** Pas një periudhe të shkurtër shpërqëndrimi, Instituti i Arkeologjisë e vazhdoi, ndonëse me mungesë të madhe fondesh, traditën e mirë në fushën e kërkimeve dhe studimeve. Në disa raste u tregua mjaft i frutshëm bashkëpunimi i Institutit të Arkeologjisë me qendra të huaja arkeologjike e me specialistë të huaj. U kryen vëzhgime e kërkime arkeologjike në pellgun e Korçës (në bashkëpunim të Institutit të Arkeologjisë me Shtëpinë e Arkeologjisë e Etnologjisë të Nanterre, Francë); në Lepenicë (në bashkëpunim me Institutin e Trashëgimisë Kulturore dhe Konservimit të Galicias, Spanjë); kërkime të reja në kalanë e Lezhës e në varrezën e Komanit (në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Kërkimeve Shkencore, Francë); në Durrës (në bashkëpunim me Universitetin Lion-2, Francë); në Zgërdhesh (në bashkëpunim me Universitetin e Frankfurtit, Gjermani); në Babunjë (në bashkëpunim me Universitetin Humboldt, (Berlin, Gjermani), në Bushat (në bashkëpunim me Universitetin e Varshavës, Poloni); në Adrianopol-Antigonea (në bashkëpunim me Universitetin e Maceratës, Itali); në Orikum (në bashkëpunim me Universitetin e Gjenevës, Zvicër); në amfiteatrin e Durrësit (në bashkëpunim me Universitetin e Chieti-t, Itali); në Finiq e Butrint (në bashkëpunim me Universitetin e Bolonjës, Itali) etj. Bashkëpunimi u vërtetua i suksesshëm edhe në rastin e botimeve e të konferencave shkencore, kombëtare e ndërkombëtare. Në vitin 1995 u realizua konferenca ndërkombëtare *Krishterimi i hershëm dhe Shqipëria*; në 1998 simpoziumi ndërkombëtar *50 vjet arkeologji shqiptare*; më 2002 simpoziumi ndërkombëtar *Viti arkeologjik 2002*; më 2004 simpoziumi ndërkombëtar *80 vjet kërkime arkeologjike në Apolloni*; më 2003-2004 simpoziumi ndërkombëtar *Kaonia antike*. Në vitet në vijim u organizuan: konferenca ndërkombëtare **Kongresi ndërkombëtar i studimeve arkeologjike Shqiptare** (janar 2016); *Zbulime të reja në trevat shqiptare* (janar 2017); *Misionet arkeologjike franko-shqiptare mes kërkimit shkencor dhe rivlerësimit turistik dhe kulturor të trashëgimisë* (mars 2018); konferenca ndërkombëtare *70 vjet arkeologji shqiptare: kërkime në fushën e arkeologjisë prehistorike* (nëntor 2018); konferenca ndërkombëtare *Greek and Roman Albania* (në bashkëpunim me Institutin e Arkeologjisë të Akademisë së Shkencave të Austrisë, Vjenë, nëntor 2018); konferenca shkencore *100 vjet gërmime arkeologjike në Shqipëri: prezenca austro-hungareze në arkeologjinë shqiptare* (dhjetor 2018), kolokiumi i 2-të

ndërkombëtar i arkeologjisë me temë *Ilirët, identitete të ndërthurura* (organizuar në bashkëpunim me Ambasadën e Francës dhe me Shkollën Praktike të Studimeve të Larta, mars 2020). Për t'u shënuar është bashkëpunimi e ndërveprimi i ngushtë midis qendrave arkeologjike të Tiranës e të Prishtinës mbas vitit 1999. Falë këtij bashkëpunimi është arritur në identifikimin e prioritete të përbashkëta, në organizimin e tubimeve shkencore e në realizimin e botimeve të përbashkëta, midis të cilave *Harta arkeologjike e Kosovës* është për t'u veçuar.

I.I. Kërkimet në fushën e antropologjisë

Pas historisë, që me të drejtë njihet si *e para shkencë albanologjike në kronologji*, shkencë që lindi bashkë me epokën e qendresës së arbërve në fund të Mesjetës, në kuadër të *studia humanitatis* të Rilindjes Europiane; pas gjuhësisë, që i la gjurmët më të hershme me fjalorin dygjuhësh të Frang Bardhit; antropologjia kulturore e shqiptarëve, pavarësisht prej emrave me të cilët është paraqitur, vjen e zë radhën përkrah tyre si *tradi të me fat*, shumë më herët se disa disiplina të tjera.

*Nxitur prej refuzimit romantik të qytetërimit industrial dhe nostalgjisë bajroniane për botë të shmangura e shoqëri të ishullzuara nga njëra anë dhe prej ideve të Gottfried Leibniz-it për vëmendjen që meritojnë gjuhët e pashkruara ose thjesht të harruara të popujve të vegjël të kontinentit nga ana tjetër, qysh në fillim të shekullit XVIII nëpër Shqipëri kaluan njëri pas tjetrit dijetarë, udhëpërshkrues, pelegrinë të zakonshëm, studiues të Orientit, gjuhëtarë të huaj, të ardhur nga shoqëritë industriale. E panjohura që gjetën jo vetëm në Shqipëri, por në gjithë vendet e rajonit, iu bë e njohur Perëndimit në formën e librave kushtuar *virtytit të humbur* të shoqërive të urbanizuara industriale nga kishin ardhur, kodeve të ashpër të rregullimit të rendit shoqëror, nderit kalorësiak, riteve primitive, miteve zanafillëse dhe besimeve të trashëguara prej paganizmit, që bashkëjetonin me vetëdijen e krishterë. Shumica prej tyre u habitën pse krahas Krishtlindjes ndër shqiptarë ekzistonte në të njëjtën ditë dhe festa pagane e Buzmit; pse malësorët i përcillnin të vdekurit në jetën e përtejme me *gjamë burrash*; pse dhëndri qëllohej me grushte prej bashkëmoshatarëve para se të bashkohej në *kuer* me nusen; pse shqiptarët u luteshin *Orëve* njësoj e më shumë se *Zojës*; pse *burri* duhet të shtiret se ka dhimbje lehonie si gruaja e tij; pse njeriu shqiptar mund të mbajë edhe emër të krishterë, edhe emër tjetër; pse brenda së njëjtës familje mund të ketë dy besime; pse malet në Shqipëri kanë festa dhe si shpjegohet kulti i vertikalishtit; pse shqiptarët quhen e vetëquhen *bijtë e shqipes*, ndërkohë që shqiponja nuk ka asnjë lidhje me totemitë e tyre, sepse *illyri fili serpentis sunt* (D. Farlati, *Illyricum Sacrum*).*

Antropologjia kulturore e shqiptarëve, duke qenë e themeluar prej dijetarësh të ardhur prej metropolesh, *lindi si një shkencë me vështrim kolonialist*. Qëllimi i saj është kryesisht t'u kujtojë atyre se si ka qenë e shkuara e brezave të mëparshëm në Europë, si e ka ndryshuar shoqërinë e Perëndimit revolucionin industrial dhe si mbijeton rendi i mëparshëm fare pranë tyre.

Edhe pasi romantizmi, bashkë me estetikën e tij, me vetëdijen kritike ndaj bashkëkohësisë, në kërkim të një shoqërie ideale, në formën e nostalgjisë (në të shkuarën) a në formën e utopisë (në të ardhmen), në shekullin XX u shpërbë e u zëvendësua me rrjedha më moderne, antropologjia kulturore, dhe jo vetëm ajo që merret me shqiptarët, vazhdoi të ruajë karakterin kolonialist e neokolonialist, si dije e qytetërimit për popujt e prapambetur, si zbulim habitës për Perëndimin e urbanizuar. Pavarësisht këtij raporti, që me sa duket ka qenë i pashmangshëm, bajronizmi në letërsi dhe iluminizmi gjuhësor laibnician nxitën një dije që u dha mundësi kulturave periferike të bëheshin të njohura në botët e qytetëruara.

Këtë qendrim antropologët e huaj as janë munduar ta fshehin. Në dekadat e para të shekullit XX baroni F. Nopcsa pati propozuar që Shqipëria të kthehej në një rezervat, në një muze të gjallë të nderit kalorësiak; madje që Europa moderne të investonte për ta ruajtur zhvillimin e këtij vendi aty ku kishte qenë, në mënyrë që brezat pasardhës të botës industriale të kishin një mundësi të shihnin si kishte qenë e kaluara e tyre: *The Land of The Living Past - Vendi që rron me të shkuarën. Muzealizimi i primitivitetit nuk ishte në të mirë të shqiptarëve*, por së paku mënyra e tyre e jetesës, mendësia, qendrimi ndaj jetës dhe vdekjes, ndaj sakrales dhe shenjtërores, u bënë të ditura. Rose Lane, studiuese dhe veprimtare e njohur amerikane e gjysmës së parë të shekullit të kaluar, në librin e saj *The Peak of Shala*, shprehej: *Unë ndieja keqardhje, mbase thjesht romantike, për zhdukjen e pashmangshme të kësaj mbetjeje të fundit të gjallë të përbashkët primitive ariane, në të cilën kanë jetuar stërgjyshërit tanë*, duke iu referuar gjendjes në malësitë veriore shqiptare. Dhe vijonte: *Unë jam konservatore, madje edhe reaksionare. Unë do të doja t'i ruaja malet shqiptare kështu siç janë. Qëllimin e udhëpërshkrueses amerikane e vijnë sot studiues të etnologjisë, shkrimtarë e dijetarë që promovojnë me zell në Perëndim besën myslimane të shqiptarëve për shpëtimin e hebrenjve; murgeshat e shtëpisë, burrneshat - virgjinitat e përbetuara, që së voni janë rikthyer si traditë dhe diku-diku jetojnë ende në Veri të vendit; gjamën e burrave; kullat e ngujimit, krimin më të rëndomtë që mund të imagjinohet si fuqi vepruese e kanuneve etj.*

Forma më vulgare dhe njëherësh më reaksionare e promovimit të identitetit shqiptar, është paraqitja e disa kategorive etike që zënë vend qendror në traditën gojore etnojuridike si cilësi etnotipike shqiptare, si virtyte përjashtimore të shqiptarëve: besa, miku, nderi. Sepse - e thonë dhe dijetarët e sotëm albanologë, një ndër ta mjeku japonez që i është kushtuar botës shqiptare Kazuhiro Yamamoto: *Besa është kodi më i veçantë në botë dhe gjendet në "Kanunin e Lekë Dukagjinit"; dhe Europës së qytetëruar do t'i duhen edhe 600 vjet për të arritur vlerat e kanunit shqiptar.*

Monumentalizimi i traditës etnojuridike gojore, i shprehur drejtpërsëdrejti apo përmes ideve-mit të saj (besa, nderi, miku, dorëzania), në rastin më të mirë është shprehje e një romantizmi të vonuar, ndërsa në rastet e anasjellta thjesht hyjnizim i prapambetjes. Besa ka hyrë, madje, dhe në ligjërimin shkencor të disa dijetarëve të huaj. Madje dhe filologët shqiptarë të brezit të modernizmit të dytë, shpesh të

cilësuar si kodifikues të modernizmit, mendojnë se njeriut shqiptar mund t'i thuhet lirisht sot: *Nëse nuk kemi çka t'i jepni botës, jepjani besën* (S. Hamiti). Një ekzotizëm i ri u shpërfaq gjatë dy dekadave të fundme. Absolutizimi i rendit etnojuridik tradicional si vlerë monumentale, identifikimi i shqiptarëve me besën dhe mikpritjen, pa shpjeguar rrugën historike të formimit të këtyre nocioneve, zgjaton një përfytyrim të shtrembër për ta. *Besa është një konvencë e rëndë kanunore ... Besa e dhënë e çon të vdekurin nga varri ... Konvenca e besës prodhon flijimin, tragjedinë dhe, nëpërmjet flijimit, prodhon heronjtë tragjikë të jetës e të literaturës.*

Për fat të keq vazhdon ende të shpërfilllet një prej ligjeve themelore të shkencës së antropologjisë: *fuqia e traditave gojore (rite, magji, rregulla, rende) pushon së vepruari pasi ato tejshkruhen, shfaqen si ligjërime i shkruar.* Këtë e pati kuptuar ndër të parët gjuhëtari E. Çabej, i cili, qysh në vitin 1936, kur shkroi librin *Elemente të gjuhësisë dhe të literaturës shqipe*, veprën më të rëndësishme të Àt Shtjefën Gjeçovit, *Kanunin e Lekë Dukagjinit*, e trajtoi thjesht si një vepër letrare, sikurse veproi jo shumë kohë më vonë edhe G. Schirò (J.), me *Storia della letteratura albanese*.

Përgjatë gati një shekulli, në dijen europiane e botërore, krahas me termin *antropologji kulturore* kanë pasur status të qendrueshëm epistemologjik edhe terma të tjerë. Në traditën ish-sovjetike kjo dije quhej *etnografi* dhe kështu vazhdon të quhet edhe sot. Kjo zgjedhje e shkencës sovjetike kishte një shpjegim. Si vend shumëkombësh e shumëgjuhësh, me shtrirje ndërkontinentale, termi *etnologji* mund të krijonte mendimin se studimet e kësaj disipline do të merreshin vetëm me *kombin e madh*, me trashëgiminë shpirtërore të *vëllait të madh*, me trashëgiminë shpirtërore ruse. Për të shmangur keqkuptimet diskriminuese, termit *etnologji* iu shmang përdorimi. Sa i takon *antropologjisë kulturore*, si në shumicën e vendeve ish-komuniste, ajo konsiderohej shkencë borgjeze.

Strukturalizmi dhe poststrukturalizmi, në gjuhësi dhe në etnologji, në këto vende ishin metodologjikisht e ideologjikisht metoda e zhvillime të huaja. Fakti që Claude Lévi-Strausse e kishte kritikuar ashpër formalizmin e kolegut të tij më të moçëm qysh kur ai botoi monografinë që e bëri të famshëm (më vonë do të botonte dhe *Poetikën e folklorit* dhe *Estetikën e folklorit*, duke i ndarë përfundimisht studimet në këtë fushë nga teoria, estetika dhe historia e letërsisë), në emër të epërsisë së struktues ndaj formës (*Structure and Form: Reflection on a Work by Vladimir Propp*); në emër të epërsisë së *paradigmatizmit* ndaj *sintagmatizmit*; në emër të epërsisë së *diakronisë* ndaj *sinkronisë*, nuk i erdhën në ndihmë e mbrojtje aspak dijetarit hebreorus. Sidoqoftë, Claude Lévi-Strausse dhe Vladimir Propp, të dy me origjinë hebreje, secili në anën e vet të litarit, mospajtues po aq sa dhe plotësues ndaj njëri-tjetrit, mbetën miq të denjë përgjithnjë dhe kritikant e ndërsjellta i botuan me bujari në librat e tyre, duke shërbyer si model për kritikizmin shkencor.

Në Francë e në Spanjë, pas Luftës së Dytë Botërore, përdoreshin paralelisht dy terma: *etnologji* për kërkime në traditën e kulturës jomateriale vendëse dhe

antropologji kulturore për studime në botët e veta: gjegjësisht në vendet që kishin qenë koloni të Francës dhe në gjithë traditën parashkrimore hispanike.

I vetmi vend ku termi *antropologji kulturore* u stabilizua në mënyrë sovrane, pa alternativë, ishin Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Duke qenë një komb i ri, pa lashtësi, i formuar shumë vonë, prej migrimeve europiane; në kushtet kur mungonte një trashëgimi zanafillëse vendëse, nuk mund të bëhej fjalë as për etnologji, as për etnografi. Kështu *antropologjia kulturore* zuri vend qendrueshëm dhe mori kuptimin e një shkence në shërbim të ndriçimit të trashëgimisë së tjetrit.

Dekadë pas dekade, midis antropologjisë dhe etnologjisë ka ekzistuar një lloj opozicioni, më shumë i nënkuptuar se i shqiptuar: *antropologjia*, përveçse shkatërroi kanonet që ndanin botën shpirtërore të njeriut me një fanatizëm pengues për kërkime të suksesshme, duke u shfaqur si *dije paradigmatiche*, njihet për *karakterin e saj transnacional, ndërkombëtar, ndërretnik, mbinacional*. Kurse *etnologjia* ruajti kuptimin e mëhershëm si *shkencë kombëtare*. Antropologjia e trashëgoi traditën e shkollës krahasimtare në dobi të zbulimit të *pranisë së tjetrit brenda nesh*, kurse etnologjia vazhdoi të mbajë qendrim kritik e deri-diku përjashtues ndaj pranisë së të huajës. Në këtë kuptim, mund të ketë *antropologji të etnosit*, por nuk mund të ketë *antropologji etnike*, sepse një përcaktim i tillë përmban një *contradictio in se*. Antropologjia e etnosit e kapërcen këtë kontradiktë të brendshme, sepse për të *arkeotipet, stereotipet* dhe *etnotipi* janë kategori të pandashme, çka e quajtura *antropologji etnike e shqiptarëve* as mund ta pretojë, as mund ta realizojë. Antropologjia kulturore i dha fund puritanizmit në studimet etnologjike, shtoi vëmendjen tek *dukuritë antropotipike* e *gjenotipike*, veçoi prej tyre shtresat *fenomenotipike*, zbuloi universalitetin e qenies njerëzore, tejkaloi dallimin për shkaqe race, etniciteti, gjuhe, besimi e zhvillimi kulturor.

Të dyja këto cilësi të antropologjisë: *kapërcimi përtej fanatizmave kombëtarë nga njëra anë dhe kapërcimi përmbi kufijtë që e ndanin objektin e saj në copëza të vogla të mjaftueshme për studiues me formim të ngushtë* (folklor gojor, folklor muzikor, etnografi, koreografi, etnomuzikologji etj.), e bënë *antropologjinë një shkencë të suksesshme dhe me perspektivë të hapur*. Ajo u bë edhe udhëheqje metodologjike. Me karakterin e saj paradigmatic, antropologjia kulturore ofroi mundësi shumë të mëdha për studime transversale dhe transnacionale.

Statusi epistemologjik i antropologjisë në periudhën midis dy luftërave u implikua shumë rëndë. Deri në kohën kur u shfaq strukturalizmi klasik në gjuhësi, sidomos me Ferdinand de Saussure-in, antropologjia kishte kuptimin e një nëndisipline në përbërje të arkeologjisë, e afërt me paleontologjinë. Dihet mirë se si u përdor antropologjia prej ideologjisë naziste në shërbim të vërtetimit të ekzistencës së hierarkisë së racave përmes krahasimit të zhvillimit historik të sistemeve eshtrorë që nga lashtësia deri në kohët moderne. Krahas mjekësisë dhe bashkë me të, antropologjia e viteve 1930-1940 mori karakterin e një shkence të nënshtruar ndaj urdhrave të Führer-it dhe të sistemit të tij për të provuar epërsinë e racës ariane

dhe padenjësine e racës hebreje (bashkë me të dhe të romëve); për të përligjur logjikën e zhdukjes përfundimtare të hebrenjve (*final solution*); për të ofruar një bazë shkencore për të drejtën e jetës dhe të drejtën e vdekjes.

Në një farë mënyre antropologjia u shndërrua deri dhe në një *shkencë aplikative*, duke i ardhur në ndihmë e duke u vënë në shërbim të ideologjisë naziste, duke marrë përsipër edhe detyrën për të identifikuar *racën e padenjës* përmes matjeve fizike të kafkës, veshëve, distancës mes syve. Kështu, antropologjia e vjetër e komprometoi veten shumë keq. Me mbarimin e luftës, termi *antropologji* me të drejtë krijoi një ndjenjë të fortë refuzimi. Emri i kësaj shkence ishte komprometuar rëndë. Ndërkaq, Claude Lévi-Strausse i kishte botuar tezat e tij themelore për antropologjinë strukturore, pavarësisht se monografia e tij do të botohej pak më vonë. Kështu, u bënë dy arsye për një ndarje definitive midis *antropologjisë kulturore* si shkencë shoqërore e trashëgimit shpirtëror të njeriut dhe *antropologjisë fizike*, si shkencë teknike-natyrore.

Kufiri ndarës midis dy antropologjive, të cilat i dhanë ndërsjelltas lirinë njëra-tjetrës për t'u zhvilluar në mënyrë të pavarur, qe shumë i saktë:

1. *Antropologjia fizike* do të vazhdonte traditën e vet, duke u çliruar prej karakterit racist dhe aplikativ që mori, si *shkencë e kafkës*, e studimit të evolucionit historik të sistemeve skeletore të bashkësive njerëzore, në shërbim të provimit të vazhdimësisë ose ndërprerjes së saj prej kohërave të mjegullta deri sot. Rezultatet e saj për të zbuluar tipologjinë e bashkësive etnike proto-europiane e proto-ballkanase, për të verifikuar tezat dhe hipotezat e shkencave shoqërore, për të hedhur dritë mbi karakterin e popullsive dhe kulturave të vdekura, gjithnjë duke iu referuar zhvillimit fizik të qenieve njerëzore, nuk munguan. Mjafton të përmendim të dhënat e Institutit Antropologjik të Gjenevës, shpallur disa vite më parë, sipas të cilave, mbi bazën e krahasimit të sistemeve skeletore të gjetur në tumat ilire me zhvillimin e sotëm eshtror të popujve të Ballkanit, rezulton se *shkalla më e lartë e iliricitetit në Danub është trashëguar tek shqiptarët*, më pak tek malazezët dhe kroatët, fare pak tek sllovenët dhe serbët.

2. *Antropologjia kulturore*, përkundrazi, u themelua si shkencë e evolucionit të mendësisë njerëzore prej stadeve më të hershme primitive deri në kohët moderne. *Antropologjia kulturore e sheh historinë e njerëzimit si histori mendimi*. Nuk është në objektin dhe as në interesin e saj se si kanë evoluar kafkat njerëzore dhe si mund të identifikohen etnitë e kombet përmes tyre, por *çfarë ka ndodhur me nënkafkën e njeriut, si është zhvilluar mendimi njerëzor prej mendimit të egër deri tek qytetërimi; ç'mbijetoja primordiale ka ende në mendimin njerëzor; si doli njeriu prej barbarisë dhe çfarë mbetet ende e egër brenda tij; cilat qenë prius parens-it e tyre, totemitë dhe tabutë zanafillëse; si dëshmohen stadet e ndarjes së mendësisë së njeriut prej primitivitetit; në ç'mënyrë dhe me ç'kronologji arsyeja njerëzore e zgjeroi pushtetin e vet brenda mendjes së homo sapiens-it duke ngushtuar gjithnjë e më shumë instiktin, zotërimin fizik; si u emancipua intelekti njerëzor duke*

shndërruar pa ndalim të pavetëdijshmen në të vetëdijshme; si qenë raportet e kryehershme të tij me jetën dhe vdekjen, me hyjnitë dhe mitet qiellore, prijësit dhe komandantët; pse kulturat etnike kanë karakterin e një palimpsesti; si janë ndërlidhur mes tyre *substratet*, *adstratet* dhe shtresat me burim gjenetik; si ka ndikuar prejardhja e bashkësive etnike dhe si e sa ka ndikuar prekja historike e fqinjësore e tyre në bashkëpërkimet ndërkulturore.

Pak nga pak, *antropologjia kulturore u shndërrua në një amzë, në një matrix* dijesh e nëndijesh shoqërore. Gjithçka që përbën trashëgimi shpirtërore të një populli, etnike apo e fituar prej të tjerësh qoftë, është objekt dhe interes i antropologjisë kulturore, duke filluar prej totemive e tabuve, miteve e riteve, deri te prindërimi.

Nuk ka vetëm një antropologji kulturore. Si shkencë paradigmatiche, antropologjia kulturore u ka dhënë mundësi studiuesve të krijojnë vazhdimisht nënfusha të reja me karakter ndërveprues brenda saj. Përveç antropologjisë së miteve, antropologjisë së religjionit, antropologjisë së etnosit, antropologjisë së identitetit, antropologjisë së kodeve rregullatorë të jetës njerëzore nga shekulli në shekull (antropologjisë së të drejtës, antropologjisë juridike), antropologjisë sociale, antropologjisë së qytetërimit, ekzistojnë nëndarje të shumta të mëtejshme, që përbëjnë secilën nëndisiplinë. Antropologjisë së besimit i brendashkruhen antropologjia e totemeve dhe tabuve; antropologjisë së miteve i brendashkruhen antropologjia e riteve dhe ritualeve, ceremonialeve dhe magjive; antropologjisë sociale i brendashkruhen antropologjia e familjes, e fisit, e kufirit; si dhe antropologjia e jetës dhe e vdekjes; antropologjisë së të drejtës i brendashkruhen antropologjia e kanunit, e statuteve, e venomeve, e rregulloreve të mjeshtërive (korporata, esnafe, sindikata); antropologjisë së identitetit i brendashkruhet antropologjia gjuhësore (antropogjuhësia dhe antropoletërsia); antropologjisë së etnosit i brendashkruhet antropogjeneza.

Në kohën e sotme antropologjia është në kërkim të mundësive të reja për zgjerim të objektit. Është më se i njohur karakteri universal i bimësisë, zhvillimi i së cilës rregullohet prej brezave klimaterikë. Por paralelisht gjithnjë e më shumë flitet për etnoflorë e *antropoflorë*, për etnofarmaci e *antropofarmaci*.

Stabilizimi i termit *antropologji kulturore* erdhi si nevojë shkencore e ndryshimit të statusit epistemologjik të kësaj shkence, krahas me ndikimin e faktorëve të tjerë: ideologjikë dhe speculativë, duke shkaktuar paqartësi, që vazhdojnë edhe sot. Ndryshimi nuk ndodhi pas ndonjë diskutimi shkencor midis studiuesve të fushës, por me një akt administrativ. Dhe kjo nuk qe pa pasoja:

Prioritete shkencore në studimet etnografike	Studimet e antropologjisë kulturore sot
Etnogjeneza e shqiptarëve	Kritika e etnografizmit të vjetër

Lashtësia e dukurive të jetës shpirtërore të popullit shqiptar	Kritika e romantizmit antropologjik
Trashëgimia gojore si histori e pashkruar e popullit	Studimet e shkallës infra-antropologjike
Tipologjia dhe morfologjia e dukurive të kulturës shpirtërore dhe materiale të popullit	Studimet ndërdisiplinare
Korpuset themelore të trashëgimit të popullit shqiptar	Studimet socio-antropologjike
Ndarja etnokrahinore e hapësirës historike shqiptare: kufijtë e krahinave dhe të dialekteve	Antropologjia e besimit
Rituale zanafillëse dhe mite paganë tek shqiptarët: ritet e lindjes, martesës, vdekjes	Antropologjia e identitetit
Etnonimi i shqiptarëve, arkeonimet, endonimet, ekzonimet: etnonimet dhe lingonimet	Antropologjia e kufirit
Tipologjia e veshjes tek shqiptarët, krahasuar me ndarjen etnokrahinore dhe dialektore: fustanella dhe xhubleta	Antropologjia e familjes
Polifonia dhe homofonia, dy dukuri paralele me ndarjen dialektore dhe krahinore: eposi dhe isoja	Antropologjia e shoqërisë kolektive
Albanizmat në trashëgiminë europiane	Gjuhët dhe kulturat në kontakt

I.I. Akademia e Shkencave dhe kërkimet albanologjike pas reformës së vitit 2007

Pas vitit 1990, me ndryshimin e sistemit politik, pritej që shkencat albanologjike, në kushtet e lirisë, të fuqizoheshin në drejtim të kapaciteteve shkencore, të trajtimit rigorozisht shkencor të problemeve e të ballafaqimit të ideve e të rezultateve. Debati i madh, i nisur pas vitit 1990 për përqëndrimin e kërkimit shkencor në institucionet e arsimit të lartë, përfundoi me reformimin e Akademisë së Shkencave në 2007, me shpërndarjen e instituteve në varësi të saj dhe grumbullimin e instituteve albanologjike në një institucion të ri, Qendrën e

Studimeve Albanologjike, me statusin e një qendre ndëruniversitare, aktualisht pa një status të qartë ligjor. Reforma në fjalë solli mbivendosje, çorientim e shpërqëndrim mjetesh e kapacitetesh, që e kanë dëmtuar jo pak profiling shkencor, si të Akademisë së Shkencave, ashtu edhe të Akademisë së Studimeve Albanologjike. Ndërkohë, kthimi i universiteteve në vatra të kërkimit shkencor, që ishte edhe qëllimi i shpallur i reformës, mbetet vetëm një tentim.

Edhe pse e privuar nga institutet që i jepnin limfë jetës shkencore, Akademia e Shkencave është munduar të luajë rolin e saj si institucioni kryesor shkencor i vendit, si qendër promovimi, koordinimi e realizimi projektsh shkencore në fushën e albanologjisë. Nga viti 2007, veç revistës së saj *Studia Albanica*, Akademia e Shkencave ka realizuar botimin e një sërë veprash albanologjike, si *Fjalori Enciklopedik Shqiptar* në 3 vëllime; *E. Çabej: një jetë kushtuar shkencës*, Sh. Demiraj; *Studime etimologjike*, E. Çabej; *Studime në fushën e gjuhës letrare kombëtare*, A. Kostallari; *Dardania: kërkime e studime arkeologjike*, M. Korkuti-L. Përzhitë-K. Luci; *Jani Vreto dhe Rilindja Kombëtare*, A. Uçi; *Studime sintaksore*, M. Domi; *Qytetërimi neolitik e eneolitik në Shqipëri*, M. Korkuti; *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, K. Frashëri; *Atlas dialektologjik i gjuhës shqipe* vëll. 2, grup autorësh; *Popullsia e Kosovës 1831-1912*, K. Prifti; *Shpirti i fjalës*, J. Bullo; *Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe*, J. Thomai; *Rreth leksikut politik e shoqëror në gjuhën shqipe*, M. Samara; *Migrimi i varfërisë*, K. Barjaba; *Arkitektura në Iliri*, A. Baçe; *Skënderbeu dhe lufta shqiptaro-osmane në shek. XV*, dokumente vëll. 1-10, K. Frashëri; *Etnografi e të folurit të shqipes*, Gj. Shkurtaj; *Shqipëria në Konferencën e Paqes 1918-1920*, M. Çami-M. Verli; *Zhvillime të mjeteve gramatikore të shqipes*, E. Likaj; *Etnogjeneza e Ilirëve*, M. Korkuti; *A. Kostallari. Vepra*, I-IV; *Historia e gjuhës së shkruar shqipe*, Sh. Demiraj; *Himni Kombëtar*, V. Tole; *Hieronimi në botën arbëreshe*, Sh. Sinani; *Korça: urbanistika dhe arkitektura*, P. Thomo; *Historia e qytetërimit shqiptar*, K. Frashëri; *Evolucioni historik i përemrave të shqipes*, K. Topalli; *Kongresi i Manastirit*, Sh. Demiraj-K. Prifti; *Udha e shkronjave shqipe. Historia e alfabetit*, T. Osmani; *Banesa popullore shqiptare*, E. Riza; *Jul Variboba në trashëgiminë e tij*, Sh. Demiraj; *Archeological studies on the prehistory of Albania*, M. Korkuti; *Sprovë për një fjalës të muzikës popullore homofonike të Shqipërisë së Veriut*, V. Tole; *Këngë popullore nga Çamëria*, F. M. Rrapaj; *Ndikime në fjalëformat e shqipes*, E. Likaj-G. Hadaj; *Qytetet dhe qytezat ilire*, A. Baçe; *Shqiptarët në artin botëror*, F. Hudhri; *Veshjet shqiptare në shekuj*, A. Gjergji; *Korrespondencë e dorëshkrime të Ali Pashë Tepelenës*, I. Koçollari; *Kodikët e Shqipërisë në "Memorien e Botës"*, Sh. Sinani; *Berati, historia dhe arkitektura*, A. Baçe-A. Meksi-E. Riza; *Arti shkëmbor në Shqipëri*, M. Korkuti-M. Xhama; *Vepra e Dritëro Agollit dhe brezi i viteve 1960*, Sh. Sinani; *Mitologjia ndër shqiptarë*, M. Tirta; *Shfaqja e antropologjisë në Shqipëri*, A. Doja; *Prapavendosja e nyjes në gjuhët ballkanike*, B. Bokshi; *Kodiku Beratas*, B. Demiraj; *Këngët partizane*, V. Tole; *Lëvizje migruese të shqiptarëve*, M. Tirtja; *Formimi i foljeve në gjuhën e sotme shqipe*, L. Buxheli; *Shekulli i Voskopojës*, P. Xhufi; *Veshje popullore shqiptare*, vëll. IV, A. Onuzi-M. Tirta-K. Ulqini-A. Bido. Në bashkëpunim me qendra të tjera të kërkimit shkencor, brenda e jashtë vendit, janë realizuar një sërë konferencash e

simpoziumesh në fushën e albanologjisë, si *Jeronim de Rada, 1814-2014* (2014), 70-vjetori i *Çlirimit-ngjarje e rëndësishme kombëtare* (2014), *Letrat shqipe dhe gjuhët e tjera të letërsisë* (2015), *akademia solemne 100-vjetori i lindjes së Dhimitër Shuteriqit* (2015); *akademia solemne Mahir Domi-100 vjetori i lindjes* (2015); konferencë shkencore ndërkombëtare *kushtuar jetës dhe veprës së Thimi Mitkos* (2015); konferenca ndërkombëtare e studimeve shqiptaro-greke me temë *Përmasa diakronike e sinkronike të ndërveprimit gjuhësor e kulturor midis grekëve dhe shqiptarëve* (2015); konferenca shkencore *A. Z. Çajupi mes së shkuarës e të ardhmes*; konferenca shkencore ndërkombëtare *1000 vjetori i Shën Gjon Vladimirit* (2016); konferenca shkencore *100 vjet nga vetëqeverimi i Korçës* (2016); forumi shkencor *Dibra dhe Radika* (2016); konferenca shkencore ndërkombëtare *Shekulli i Kadaresë* (2016); konferenca shkencore ndërkombëtare *Shekulli i Kadaresë* (2016); konferenca shkencore ndërkombëtare *në 250-vjetorin e lulëzimit të qytetërimit të Voskopojës* (2017); konferenca shkencore ndërkombëtare *Risi arkeologjike nga trevat shqiptare* (2017); konferenca shkencore ndërkombëtare *Një rilindje para Rilindjes* (në bashkëpunim me Universitetin e Vlorës, 2017); konferenca shkencore ndërkombëtare *Qytetërimi i Voskopojës dhe shekulli i iluminizmit në Ballkan* (2017), konferenca shkencore ndërkombëtare *Shqiptarët dhe koalicioni antifashist në Luftën e Dytë Botërore* (2019). Me konferenca e simpoziume të veçanta është nderuar e vlerësuar vepra e punëtorëve të mëdhenj të shkencës albanologjike e të kulturës shqiptare, si Eqrem Çabej, Aleks Buda, Dhimitër Shuteriqi, Ismail Kadare, Mahir Domi, Dritëro Agolli, Rexhep Ismajli etj. Me rastin e përmbylljes së veprimtarive shkencore me rastin e 550-vjetorit të Gjergj Kastriot Skënderbeut, Akademia e Shkencave shpalli hapjen e *Librit të Artë të Albanologjisë*, ku u shënuanemrat e studiuesve të shquar të veprës së Heroit, Aleks Buda, Kristo Frashëri, Alain Ducellier (Francë), Konstantin Sathas (Greqi), Franz Babinger (Gjermani), Francisc Pall (Rumani), Halil Inalçik (Turqi), Peter Bartl (Gjermani). Prej vitit 2017, Akademia e Shkencave ka shpallur dhënien e çmimit *Eqrem Çabej* për veprën më të mirë në fushën e albanologjisë.

Veprimtaria më e rëndësishme shkencore ndërkombëtare e organizuar nga Akademia e Shkencave në bashkëpunim me institucione të tjera shkencore shqiptare e të huaja është konferenca kushtuar 550-vjetorit të lindjes së Gjergj Kastriotit – Skënderbeut, me dy faza, “lectio magistralis” dhe konferencë (2018).

II. Një kuvend i ri për studimet albanologjike

Duke marrë parasysh kohën e gjatë që ka kaluar nga Konferenca II e Studimeve Albanologjike (1968) dhe zhvillimet e reja që ndërkohë kanë ndodhur në këtë fushë, paraqitet e domosdoshme nevoja e thirrjes së një konference të re në hullinë e të parave. Në këto dekada kanë ndodhur ndryshime të rëndësishme. Janë

fuqizuar qendrat e dikurshme e kanë lindur qendra të reja e aktive të studimeve albanologjike, siç janë ato të Palermos, Kozencës, Mynihut, Regensburgut, Vjenës, e pas vitit 1999 kanë joshur një zhvillim të madhstudimet albanologjike në Republikën e Kosovës. Në këto kushte, është bërë i domosdoshëm një rivlerësim i rezultateve dhe ripërcaktim i prioriteteve. Një konferencë e tillë do ta sjellë shkencën albanologjike në vëmendje të publikut e të institucioneve. Nga ana tjetër, konferenca do jetë një rast i mirë për të hequr një vijë të prerë ndarëse midis shkencës e pseudoshkencës. Kjo e fundit ka lulëzuar si asnjëherë më parë këta 30 vjetët e fundit, duke mbjellë konfuzion me përpjekjet e saj të zhurmshme për përmbysjen e rezultateve të shkencës albanologjike, duke sjellë paradigma “teorish”, “zbulimesh” e “gjetjesh” të mbështetura në pseudoteza e të frymëzuara nga dilentatizma romantikësh, nacionalizma anakronike, filozofi e deri ideologji radikale. Për statusin e historinë e saj, Akademia e Shkencave të Shqipërisë ka detyrimin të orientojë drejt, këtu në Shqipëri, kërkimin shkencor drejt çështjeve parësore të albanologjisë, mbi kritere e principe rreptësisht shkencore e mbështetur fort në lirinë akademike, në qasjen ndërdisiplinore në sinergji me institucionet shkencore të fushës së albanologjisë, brenda dhe jashtë vendit. Nisur nga prurjet, tezat, debatet e linjat e reja të kërkimit shkencor që janë identifikuar ndër kohë, Kuvendi i Studimeve Albanologjike, që do mbahet vitin e ardhshëm në Tiranë, do të mund të fokusohet në disa çështje kryesore, që do të ishin:

I. Arkeologji, histori antike dhe histori arti

1. Të dhëna të reja nga kërkimet në fushën e prehistorisë, nga studimi i qendrave të reja të periudhës së Paleolitit, Neolitit e Bronzit. Kontribut për rindërtimin e pejsazhit shoqëror e kulturor të periudhës, të marrëdhënieve me kulturat fqinje dhe të proceseve etnike kulturore, mbi bazën e kërkimeve më të reja.

2. Problemi i migracionit indoeuropian dhe i etnogjenezës së ilirëve, nëpërmjet konfrontimit të rezultateve dhe pikëpamjeve të ndryshme.

3. Mbi bazën e të dhënave të reja nga kërkimet për periudhën e Bronzit e të Hekurit, do trajtohet problemi i formimit të grupeve të mëdha kulturore në hapësirën protoilire dhe i marrëdhënieve midis tyre dhe kulturave bashkëkohore fqinje. Do analizohen ndryshimeve shoqërore, që përcaktuan migracionet e brendshme e të jashtme. Mes këtyre të fundit do të trajtohet ***edhe çështja e migracionit mesapik dhe profilit kulturor të tij.***

4. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet trajtimit të periudhës historike në trevat ilire, kur ndeshet *zhvillimi i dukshëm i një qytetërimi urban*. Mbi bazën e të dhënave arkeologjike dhe të atyre historike, do të analizohen *fillimet e procesit të urbanizimit*, e në këtë kuadër, krijimi i kolonive helene dhe *protourbanizimi i prapatokës ilire*. Do të paraqiten të dhëna të reja nga kërkimet e kryera në këto qendra, të cilat shpalosin me një panoramë të re sociale e kulturore.

5. Mbretëritë ilire, mbretëria dardane dhe mbretëritë epirote, me një ballafaqim të të dhënave të reja që thellojnë njohuritë për rolin e tyre në kontekstin e ngushtë e të gjerë gjeografik dhe **njohjen e shkallës së organizimit shtetëror ilir**.
6. Të reja mbi kulturën e kolonive helene dhe të qendrave urbane ilire dhe mbi ndërveprimin mes tyre: **ilirciteti i trashëgimisë materiale** dhe dukuritë e ardhura.
7. Periudha romake dhe ndryshimet politike, shoqërore e kulturore që e shoqëruan, **ilirciteti dhe romanitas** mbi bazën e të dhënave të reja arkeologjike e historike; vendi i historisë ilire në kontekstin e historisë së Perandorisë Romake.
8. Rivlerësim i antikitetit të vonë dhe të vendit të tij në kalimin historik drejt një faze të re, asaj të Mesjetës; **epoka e kapërcyellit në arkeologji** (shek. VI-VIII); **proceset sociale e etnokulturore që shoqëruan kalimin nga ilirët e antikitetit tek arbërit e mesjetës**: përhapja e Krishterimit në trevat ilire.

II. Në shkencën e historisë (prej Antikitetit e Mesjetës deri në Kohën e Re)

1. Arbëria romano-bizantine në agim të Mesjetës: vendi i saj në gjeopolitikën e Justinianit.
2. Pas dyndjes së popujve dhe ardhjes së sllavëve: riorganizimi i territorit në Arbërinë byzantine, **regjimi i themave** dhe **promovimi i aristokracisë arbërore**.
3. Krishtërimi roman dhe krishtërimi bizantin para dhe pas skizmës së vitit 1054: përthyerje etnike dhe religjioze-kulturore në Arbërinë e shek. VI-XI.
4. **Ilirët në librat dhe kronikat e Krishterimit të hershëm**, kontributi i ilirëve në kulturën e krishterë (Shën Asti, Shën Jeronimi, Shën Niketa).
5. Arbëria mes Simeonit e Samuelit bullgar (shek. IX-X): Bazili II, rikthimi i Bizantit.
6. Arbëria në periudhën e dinastisë së Komnenëve: **koha e artë e aristokracisë ushtarake arbërore**.
7. Epoka e kryqëzatave: **Via Egnatia**, rruga e përplasjeve të mëdha Lindje-Perëndim.
8. Mëdyshjet mes Bizantit e Perëndimit: **princër e sebastë arbërorë** (shek. XI-XIII).
9. Manfredi Hohenstaufen dhe Charles I Anzhu në Arbëri: ndryshimi i peizazhit social e kulturor.
10. Dinamika serbo-shqiptare në Arbërinë e Veriut në shek. XIII-XIV: ekspansioni i mbretërisë së Rashës në shek. XIII-XIV dhe ndryshimet social-kulturore që ai solli në trevat shqiptare, **shqiptarët në Zakonik-un e Stefan Dushanit**;
11. **Familjet patronimike arbërore, organizimi parashtetëror i arbërve, rilindja feudale**: baronë, kontë, sebastokratorë e despotë arbërorë në gjysmën e dytë të shek. XIV: **tentativa e “mbretit” Balsha II (1370-1385)**.
12. **Jeta urbane në Shqipëri sipas statuteve të periudhës humaniste europiane**.

13. Impakti i parë me turqit osmanë: *zotër që luftojnë e zotër që konformohen.*
14. Faktori i tretë: Republika e Venedikut: nga pushtimi me luftë, te pushtimi me diplomaci; *Arbëria veneciane në gjysmën e parë të shek. XV.*
15. ***A ishin arbërit pjesë e Rilindjes Europiane në zhvillimin shpirtëror e ekonomik.***
16. Invazioni osman dhe dimension i ri gjeo-strategjik i Arbërisë së Gjergj Kastriot Skënderbeut: një mur i pakapërcyeshëm (*murum firmissimum*) i Europës së krishterë.
17. Qëndresa si zgjidhje: Skënderbeu dhe tentativa e ngritjes së një *regnum Albaniae*.
18. Venediku, ose *armiku brenda mureve* (1444-1463). *A është demonizuar Perëndimi në letërsinë gojore dhe në historiografi.*
19. Një luftë për jetë a vdekje, mes admirimit dhe ankthit të Europës (1451-1468).
20. ***Ndryshimi i elitave arbërore në prag të pushtimit otoman:*** Skënderbeu në histori - një meteor, apo një yll polar?
21. Pushtimi osman dhe valët migratore drejt Italisë e Dalmacisë sipas të dhënave të reja: rëndësia e tyre për sqarimin e etnogenezës së shqiptarëve.
22. Riformatimi osman i Arbërisë: spahinj të krishterë e spahinj myslimanë.
23. Otomanizimi dhe islamizimi, dy procese historike për të mos u ngatërruar.
24. Kryengritje e komplete antiosmane në Arbërinë e shek. XVI-XVII.
25. Ndërprerje, vazhdimësi e risi social-kulturore në Arbërinë nën sundim osman: *elita të vjetra e elita të reja; masakra e Manastirit dhe vonimi i një elite tjetër.*
26. Jehona e luftërave austro-turke në Shqipëri, fillimet e *cultus protectorat-it* të Habsburgëve mbi katolikët shqiptarë dhe pasojat e tij në marrëdhëniet me pushtetin osman dhe në marrëdhëniet ndërshtetërore (shek. XVII-XIX).
27. *Shqiptarë, grekë e serbë* nën Perandorinë Osmane: në agim të konflikteve nacionale - *shqiptarët në revolucionin kombëtar grek.*
28. *Turq që luftojnë kundër turqve:* nga kryengritja për mosbindje, ***tek ideja e krijimit të një shteti mysliman shqiptar:*** pashallëqet e Janinës, të Shkodrës dhe të Beratit dhe raportet mes tyre (shek. XVIII-XIX).
29. Në kërkim të rrënjëve: vetëdija e rilindur dhe fillesat e lëvizjes kombëtare, roli i arbëreshëve të Italisë (shek. XVIII-XIX).
30. Paradigma e re e rilindësve të Shqipërisë: gjuha, jo feja.
31. Kurba ngjitëse e Lëvizjes Kombëtare: nga lëvizje kulturore, drejt organizimit politik e ushtarak - Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe afirmimi ndërkombëtar i kombit shqiptar.
32. Austro-Hungaria heq dorë nga *Cultus protektorati* dhe i përshtatet paradigmës së Rilindasve: jo një minishtet katolik, por një shtet laik shqiptar: *Albania* e Faik Konicës.

33. Viti 1908 dhe shpërthimi i idesë dhe i veprimit kombëtar. Roli i diasporës.
34. Reaksioni xhonturk dhe kryengritjet e mëdha në Shqipërinë e Veriut (1910-1912).
35. Elita të vjetra dhe elita të reja përballë çështjes kombëtare: **sovranistë e suzerenistë**.
36. Rrugëtimi i Ismail Qemalit, nga reformator i Perandorisë Osmane në flamurtar i pavarësisë shqiptare: ndarja nga *të vetët*.
37. Nga qeveria kombëtare e Vlorës në qeverinë ndërkombëtare të Londrës: modeli monarkisto-feudal në vend të atij republikano-liberal.
38. Shqipëria në tallazet e luftrave ballkanike dhe të Luftës I Botërore.
39. Paqja e rrezikshme 1918-1920: *Shqipëria në tregun e politikave ndërkombëtare*; Konferenca e Paqes 1919-1920.
40. Përsëri zgjidhja nga brenda: Kongresi i Lushnjës dhe mobilizimi luftarak i popullit për bashkimin e krahinave të Gjirokastrës, Shkodrës, Korçës dhe Vlorës me territorin kombëtar; njohja ndërkombëtare e shtetit shqiptar dhe pranimi i tij në Lidhjen e Kombeve.

II. Në shkencat gjuhësore:

II.1. Në gjuhësinë historike:

1. Karakteri indoeuropian i gjuhës shqipe.
2. Rreth karakterit *satem* të shqipes dhe *centum* të mesapishtes (ilirishtes).
3. Ilirishtja apo protoshqipja? Besët dhe ilirët e shqiptarët.
4. Origjinës së gjuhës shqipe prej ilirishtes dhe tezat alternative.
5. *Greqishtja e vjetër dhe latinishtja si dëshmuese të lashtësisë së shqipes dhe të marrëdhënieve me ilirishten*; relacioniet parahistorike të gjuhës shqipe me gjuhët e lashta.
6. Etnogjeneza ilire e shqiptarëve përmes dëshmimeve gjuhësore.
7. Pse nuk u shkrua ilirishtja.
8. Shqipja në kapërcyell, dukuritë e divergjencës: rotacizmi, nazalizimi dhe dukuri të tjera që krijuan ndarjen dialektore.
9. Janë afruar apo larguar dialektet në rrjedhë të kohërave.
10. Probleme të periodizimit të shqipes në zhvillimin historik.
11. *Ishujt gjuhësorë* të shqipes në ndihmë të sqarimit të historisë së saj.
12. Zhvillime historike të strukturës gramatikore të shqipes.
13. Marrëdhëniet e shqipes me gjuhët e tjera në zhvillimin e saj historik.
14. Ngulimet gjuhësore në Greqi, Itali, Bullgari, Ukrainë, Kroaci etj.

15. Lingonimi i shqipes në rrjedhë të shekujve dhe etnonimi i shqiptarëve sot.

II.2. Ngjarje që kanë përcaktuar rrugëtimin e shqipes në shekuj

1. Latinizimi i alfabetit të shqipes dhe procesi i gjatë i multialfabetizmit.
2. Kuvendi i Arbënit
3. Kongreset gjuhësore për shqipen e arbërishten në shekullin XIX
4. Kongresi i Manastirit
5. Komisia Letrare e Shkodrës
6. Botimet filologjike të teksteve të vjetra shqipe - themel i domosdoshëm për studimin e historisë së gjuhës shqipe

II.3. Gjuha shqipe në rrafshin sinkronik

1. Gjuha shqipe dhe shqipja standarde, studimet për përmirësimin, shtrirjen e përsosjen e funksioneve: sesionet shkencore të vitit 1952; konferencat shkencore albanologjike; Konsulta e Prishtinës (1968); Kongresi i Drejtshkrimit (1972); konferencat kombëtare për leksikografinë, terminologjinë; ekspeditat hulumtuese dialektologjike e leksikologjike në terren.
2. Studime: fusha, metoda e shkolla gjuhësore: dialektet e shqipes, - burim i pashteruar hulumtimi; studime sociolinguistike; studime etnolinguistike.
3. Studime në fushën e fonetikës e të fonologjisë.
4. Studime në morfologji e fjalëformim.
5. Studime për morfologjinë e eptimit.
6. Çështje të sintaksës së sotme.
7. Studime në fushën e ligjërimit gjuhësor; arritje në studimin e stilistikës gjuhësore.
8. Studime në fushën e leksikologjisë e të semantikës leksikore.
9. Leksikografia historike, sinkronike, njëgjuhëshe, dygjuhëshe; vepra të pritshme
10. Terminologjia dhe sfidat e saj në epokën e globalizmit.
11. Studimet onomastike (etnonime, patronime, toponime).
12. Sistemet teorike e shkollat gjuhësore në shërbim të albanologjisë.

III. Në studimet e antropologjisë kulturore

1. Mitet parahistorikë zanafillës të popullit shqiptar.
2. Rituale primitive parashqiptare në kulturën tradicionale dhe karakteri i tyre.

3. Identiteti i shqiptarëve në procesin e zhvillimit historik përmes dëshmime të kulturës materiale e shpirtërore.
4. Homogjenë në etnicitet dhe heterogjenë në besim: roli i përbërëses kulturore dhe gjuhësore në identitetin e shqiptarëve.
5. Koncepti për tjetrin në kulturën tradicionale shqiptare: etnonime të popujve europianë në folklorin shqiptar.
6. Trashëgimia kulturore shqiptare si një palimpsest: shtresime vendëse dhe të ardhura.
7. Ndarja krahinore e popullit shqiptar përtej kufijve shtetërorë.
8. Gjurmë të paganizmit në trashëgimin shpirtëror të popullit shqiptar.
9. Krishterimi i hershëm në traditën gojore shqiptare.
10. Toskë e gegë, fustanellë e xhubletë, polifoni e homofoni.
11. A janë / kanë statutet mesjetare traditë etnozakonore shqiptare.
12. Kur u formua dhe kur u mbyll eposi heroik legjendar i shqiptarëve.
13. Marrëdhëniet shqiptaro-sllave në trashëgiminë gojore të hershme.
14. Karakteri europian i ciklit heroik legjendar.
15. Etnotipi shqiptar përmes kulturës gojore.
16. Shtresime universal në të drejtën etnozakonore shqiptare.
17. Albanizmat: koncepti për besën në ligjërime etnografike të fqinjëve.
18. Ballkanizimi i dukurive folklorike shqiptare: rasti i baladave.
19. Tradita gojore shqiptare dhe ajo ballkanike: përdorimi dhe keqpërdorimi në letërsi.
20. Kujtesa dokumentare dhe kujtesa gojore: histori paralele dhe ndërplotësuese.

IV. Në studimet letrare

1. Dukuritë letrare shqiptare dhe dukuritë letrare europiane: vonesat dhe asimetritë.
2. Letërsi shqipe si letërsi europiane.
3. Letërsia shqipe si letërsi e identitetit dhe promovuese e botës shqiptare.
4. Letërsia shqipe si letërsi etnografike në studimet europiane.
5. Letërsia shqipe si dije universitare europiane dhe botërore.
6. Cilin Kadare të lexojmë: dy lexime në krahasim.

7. Autorë dhe vepra me njohje dhe vlerësim përtej kufirit të shqipes (De Rada, Fan Noli, Fishta, Migjeni, Ali Podrimja).
8. Letërsia shqipe në botimet antologjike europiane dhe botërore.
9. Autorët shqiptarë në lexicon-ët terminologjikë dhe enciklopedikë.
10. Letërsia shqipe në studimet e gjuhëtarëve europianë.
11. Letërsia shqipe dhe çmimet ndërkombëtare për letërsinë.
12. Letërsia shqipe në studimet krahasuese.